

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 E mërkurë, 22 shtator 2021

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari merr pjesë nëpërmjet

4 videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 09.31.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëdita. Mirë se erdhët.

8 Zonja sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
10 kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i
11 Specializuar kundër SaliH Mustafës.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit, zonja sekretare.

14 U lutem tani palëve, Mbrojtëses së Viktimave dhe Zyrës
15 Administrative që të prezantohen, duke filluar nga Zyra e
16 Prokurorit të Specializuar.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës,
18 mirëdita të gjithëve, Prokuroria përfaqësohet sot nga unë,
19 Cezary Michalczuk, prokuror, Silvia D'Ascoli,
20 ndihmësprokurore, Filippo de Minicis, një tjetër
21 ndihmësprokuror, dhe Alex Whiting, zëvendës prokuror i
22 specializuar. Me ne sot në gjykatë sot ndodhet menaxherja e
23 lëndës, Julie Mann.

24 Faleminderit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Faleminderit.

2 Ju lutem, Mbrojtësja e Viktimave?

3 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve. Mirëdita të
4 nderuar gjykatës. Mirëdita të gjithëve. Mbrojtja e Viktimave
5 përfaqësohet sot nga unë, Annie Pues, kryembrojtëse dhe Mari-
6 Pier Barbeau, si nëpunëse juridike.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit. Tani ja jap fjalën Mbrojtjes.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Më
10 quajnë Julius Von Bone, përfaqësoj zotin Mustafa si
11 kryeavokat. I pranishëm është zoti Shala, bashkëavokati dhe
12 zoti Fatmir Pelaj, hetuesi. Zoti Mustafa është i lidhur në
13 distancë, është i pranishëm në distancë, gjithashtu.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Faleminderit.

16 Zyra Administrative, ju lutem?

17 Z. ROCHE: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës, më
18 quajnë Ralph Roche nga Zyra Administrative.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
20 hir të procesverbalit, Trupi Gjykues numër 1 përbëhet nga
21 gjykatës Rolad Dekkers, gjykatësi Gilbert Bitti, gjykatësi
22 Vladimir Mikula, gjykatës rezervë dhe nga unë Mappie Veldt-
23 Foglia, kryegjykatëse e Trupit Gjykues Nr. 1.

24 Përpara se të fillojmë me vijimin e pyetjet të
25 dëshmitarit që kishim dje, do të shpjegoj shumë shkurt sesi e

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 kemi programin sot. Kemi ndërmend që t'i mbyllim pyetjet që i
2 bëhen dëshmitarit 3593 dhe të fillojmë nesër me pyetjet që do
3 t'i bëhen dëshmitarit tjetër. Kështu e kemi programin sot.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar gjykatës, nëse mund të
5 shprehem nesër i akuzuari do të jetë i pranishëm në sallë të
6 gjyqit.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Dhe mbase në çdo seancë që do të
10 jetë dëshmitari në fjalë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit që e informuat Trupin Gjykses.

13 Shoqëruese e gjykatës, a mund ta shoqëroni dëshmitarin
14 për të hyrë në sallën e gjyqit ju lutem?

15 Zoti Mustafa, më dëgjoni?

16 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e nderuar [E
17 padëgjueshme].

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
19 t'ju informuar që tani ju shohim në sallën e gjyqit përmes një
20 ekrani të madh. Kështu po merrni pjesë sot.

21 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e nderuar,
22 faleminderit.

23 [Dëshmitari hyn në sallë]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
25 Dëshmitar, mirëmëngjesi.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në kundërpjetje nga Z. Von Bone
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Page 4

1 ËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
3 se erdhe përsëri. Si ndihesh sot?

4 DËSHMITARI: Mirë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,
6 shumë mirë, z. Dëshmitar. Do të vazhdojmë sot me pyetjet që do
7 të t'i bëjë avokati i Mbrojtjes. Kështu që ja jap fjalën
8 avokatit të mbrojtjes për të përfunduar pyetjet që ai ka.

9 Zoti dëshmitar, dua të të kujtoj që ende -- dua të të
10 kujtoj betimin që ke bërë me thënë të vërtetën. E kupton?

11 E shoh që po tund kokën, po.

12 Zoti avokat, ju lutem keni fjalën. Të kanë mbetur edhe
13 një orë e 32 minuta të mbetura, një orë e 32 minuta.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
15 gjykatës.

16 DËSHMITARI: W03593 [Vazhdim]

17 Marrje në kundërpjetje nga Zoti Von Bone:

18 Py. Mirëdita, z. Dëshmitar.

19 Do t'i lutem Gjykatës që të kalojmë në seancë private, besoj
20 për 25 minuta.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja
22 Sekretare, a mund të kalojmë në seancë private, ju lutem.

23 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
25 jemi në seancë private.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (Vazhdim) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në kundërpjetje nga Z. Von Bone
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 5

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Mund të vazhdoni, i nderuar avokat.

4 Z. VON BONE: [Përkthim]

5 Py. Zoti Dëshmitar, dje folëm për ditën kur të liruan, ishte
6 data e 18-të, siç the, dita e 18-të. Desha të të pyes këtë: i
7 ke dhënë Prokurorit një deklaratë.

8 Është, për Trupin Gjykses, është me numër ERN 061015-TR-
9 ET, Pjesa 2, e Rishikuar, e datës [REDAKTUAR].

10 Py. Jam në faqen 13 të kësaj deklarate që i ke dhënë
11 Prokurorit.

12 Zoti Dëshmitar, ke thënë se të kanë mbajtur në haurin nga
13 i cili në fund fare të liruan, pra nga je dalë andej. Ke thënë
14 se shtatë apo tetë ditë para se me të liru, ishte një zotëri
15 aty, që hyri në haur dhe ja të ta them si është thënë aty, jam
16 në rreshtin 8, ke thënë:

17 "Më fal, kam përmend, kam harru me përmend edhe këtë dhe
18 nuk e di a kam përmend aty, ai person ishte si ky kolegu juaj
19 këtu, edhe seç kishte një çantë, një farë çante. Ai ishte si
20 ky kolegu juaj këtu, ai ish kon njeri i mirë. Ai o erdh e na
21 ka pyet qysh po jetoni, a po hani bukë. Dhe ne i tregum çfarë
22 kishte ndodh, por nuk ja tregum t'gjitha". A të kujtohen këtu
23 fjalë, këto -- kjo deklaratë që ke dhënë?

24 A të kujtohet që ja ke thënë kështu Prokurorit kur ke fol
25 për këtë person, për këtë zotëri?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në kundërpjetje nga Z. Von Bone
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 6

1 Pë. Po.

2 Py. Zoti Dëshmitar, fol të lutem më afër me mikrofonin që të
3 dëgjohesh më qartë. Faleminderit shumë, z. Dëshmitar.

4 Ky njeri, çfarë mund të na tregosh për atë njeri që është
5 ardh aty dhe ju ka pyet a keni bukë me hangër?

6 Pë. Muj me fol?

7 Py. Patjetër.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Patjetër.

10 DËSHMITARI: Po, në atë kohë ai zotëria ka ardhur, a kon i
11 djalë shumë i mirë edhe shumë simpatik. Unë -- nuk a kon i
12 trashë, a kon i hollë. Ka pas një çantë në krah. Pra ne s'e
13 këna dit kush mun me kon ai. Ne normal jena kon të burgosur,
14 por ai o ardh dhe ka i ka thanë rojës krejt ça jan kon i ka
15 thanë "dilni jashtë". Atëherë e këna kuptu që është një njeri
16 i mirë, i drejtë. Edhe na ka pyet, a ju kanë rreh, a ju kan
17 maltrajtu, a ju kanë dhënë bukë, krejt na ka pyet, nuk kena
18 guxu me thanë kurr gjë, me i thonë se na kanë rreh, nuk kena
19 guxu se normal, s'e kena dit kush asht ai personi. Kena mendu
20 se mos na njeri i maskum, kështu, a po din? Edhe pe asaj dite,
21 qe ai person aty, ishalla allahi i ndihmon, kur n'jetë mo kush
22 as nuk na ka rreh, as -- edhe bukë janë munu me na dhanë pak
23 diçka ma shumë, e ka konë ma në rregull e ma mirë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti

25 Von Bone, unë kam një pyetje për ju.

1 Cila është lidhja -- domethënë pse duhet bërë kjo pyetje
2 në seancë private? Se ajo që dëgjuam tani nga dëshmitari por
3 edhe nga pyetja juaj, sipas mendimit tim kjo gjithashtu mund
4 të ishte në publik. Unë e thash edhe dje, dua sigurisht që ta
5 mbroj konfidencialitetin, fshehtësinë e informacionit në
6 sallën e gjyqit por njëkohësisht nuk dua që ky gjyq të jetë
7 privat.

8 I nxis të gjitha palët të jenë shumë të kujdesshëm kur të
9 bëjnë kërkesa për të qenë në seancë private. Sepse edhe këto
10 kalimet unë do të preferoja më mirë që të bënit sa më shumë
11 kalime nga seancë private në të hapur, nga të hapur në private
12 se sa të mbetemi në private.

13 Seancat private duhet të jenë të minimizuara. Nëse edhe
14 sikur gabimisht na shpëton ndonjë informacion konfidencial,
15 mund ta heqim, mund ta fshijmë nga procesverbali. Unë e kam,
16 ne e kemi thënë, në urdhrin për zhvillimin e procesit gjatë
17 konferencës përgatitore. Është shumë e rëndësishme që t'i
18 grupojmë pyetjet në atë mënyrë që të kemi seancë private deh
19 seancë publike, por nëse është e vështirë që të bëhet kjo gjë,
20 atëherë është e vështirë, s'kemi ç'të bëjmë kështu që do të
21 bëjmë alternim pastaj, midis publike edhe private edhe më
22 shumë.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju kuptova, e nderuara Gjykatëse.
24 Atëherë kërkoj që të kalojmë -- më vonë do kërkoj që të
25 kalojmë në seancë publike por...

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
2 mirë, po kjo pyetje pse duhej të ishte bërë në seancë private,
3 kjo pyetje që sapo u bë?

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Nëse do të kalojmë në faqen
5 tjetër, aty përmenden emra.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
7 kuptova.

8 Z. VON BONE: [Përkthim]
9 Py. Po edhe atë situatë, pak më tutje, ke thënë për këtë
10 person: "Kishte edhe të tjerë, kështu që jena bo, 12 - 13 vetë
11 aty. Prej asaj dite që erdhi ai zotëria, qëndruam edhe nja 7 a
12 8 ditë, dhe prej asaj dite, askush nuk na ka rrah. Prej asaj
13 dite, nuk na ka rreh kush. Nuk e di se kush a konë ai person,
14 me mujt me e pa sot, do kisha dasht me e falenderu". Është e
15 saktë që ke thënë kështu, z. Dëshmitar?

16 Pë. Po.

17 Py. Pra kaluan edhe 7 a 8 ditë deri sa ju liruan. E saktë?

18 Pë. Po.

19 Py. Ishe në atë haurin e dytë, në haurin prej nga të liruan
20 pastaj. Ishe jo vetëm, aty me të tjerë, "12 - 13 jemi konë",
21 the. Tani unë dua të kthehem më pas në kohë. Përpara se të
22 shkoje te ky hauri i dytë, nuk e di a më ndjek deri këtu.

23 Pë. Po.

24 Py. Se bashkë me [REDAKTUAR], të çuan te ky hauri i dytë dhe
25 fillimisht kishte dy a tre njerëz aty, dy a tre vetë. Kur ju

1 kanë çu aty në atë haurin e dytë, bashkë me [REDAKTUAR], në

2 atë moment e gjete, e pe [REDAKTUAR]?

3 Pë. Po.

4 Py. Ti e njihje [REDAKTUAR]?

5 Pë. Po.

6 Py. Edhe ai të njihje ty, e njihnin njëri-tjetrin, pra

7 njiheshit.

8 Pë. Po.

9 Py. Edhe njëherë që ta përsëris, të çuan bashkë me
[REDAKTUAR] te

10 hauri i dytë dhe aty gjete [REDAKTUAR]. A të kujtohet

11 ndonjë tjetër veç këtyre, që ishte aty, që i gjete aty?

12 Pë. Nuk më kujtohet saktësisht, tash kom harrue. Jan konë nja

13 katër veta apo pesë, apo sa janë konë, nuk muj me ditë. Se

14 s'më ka interesue, se kam problemin tem, dhe s... veç ata të

15 dy, ç'ata t'tre në t'vërtetë, jom konë afër atyne, e kom

16 ngjoft [REDAKTUAR], ç'aty e kom ndingju, se

17 nuk po di, veç a konë. [REDAKTUAR], me te u kom shoqnu ka

18 pak, po s'kena guxu se thash se o konë rrezik me fol mes vedi.

19 E kena pas t'ndalume me fol mes veti, e këna pas t'ndalume.

20 Py. Te ky hauri i dytë, sigurisht e pe [REDAKTUAR]. Du me

21 t'pyet, a e pyete ti [REDAKTUAR] pse ishte aty?

22 Pë. Po.

23 Py. Çfarë të kallëzoi [REDAKTUAR]?

24 Pë. Ai më tha se gjoja e kanë marrë diçka [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR] Manej nuk di.

4 Py. Po ku e kishin kap, nga e kishin sjellë, nga i njëjti
5 vend nga ishe edhe ti?

6 Pë. Nuk e di ku e kanë marrë, diku -- nuk une [e
7 pakuptueshme] se diku, nuk e di ku.

8 Py. Ke thënë se në atë haurin e dytë, shumë vetë i kishin
9 rreh, u kishin ra, i kishin mëshu n'shpulla, e saktë?

10 Pë. Po.

11 Py. A mundesh me na e shpjegu kur i rrifshin, i merrshin i
12 nxirrshin jashtë, apo ndonjëherë ndodhte që edhe i rrifshin
13 aty ku ishin, në praninë tuaj domethënë?

14 Pë. Po, ka ndodh ajo, dy tri herë, s'kam mujt me ditë, jon
15 ardh me na rraf t'tanë vetë, po jo me maltrajtime t'forta, po
16 na ka dhanë ka një shuplakë, ka dy. Diku na i kanë sjellë
17 shkelma, q'ashtu, rend t'tanëve na kanë rrah. Na kanë bo
18 barabartë, s'na kano bo me hile kurjukna.

19 Py. A ka ndodh që edhe merrshin ndonjë, e nxirrshin jashtë
20 dhe pastaj kur e kthenin ishte me të nximë, me shenja që mund
21 të kuptohej që e kishin rrahur fort?

22 Pë. Po.

23 Py. A të kujtohet sa herë e kanë qit [REDAKTUAR] me e
24 rrah, që e ke parë ti pastaj të kthehet?

25 Pë. Jo. Atë s'e kanë rrahur kurrë. Hiç.

1 Py. S'e kanë rrahur kurrë?

2 Pë. Unë mendoj veç ato shuplakat që i ka marrë, për me neve,
3 kur janë hi, do t'jerë një herë, a mundet -- unë nuk kom vrej
4 që e morë atë e kanë çua me e rrah. Se këtë nuk di, jo.

5 Py. Po e pe që i kanë ra n'shuplakë, po?

6 Pë. Po.

7 Py. Sa vetë i kanë ra n'shuplakë?

8 Pë. Po sa herë na kanë vre t'tanëve ato, jena kanë aty krejt
9 mrena, nuk na kanë zgjedh "kush je ti, kush a ai" po rend na
10 kanë hyrë e na kanë rreh. Normal, shuplaka na kanë dhanë, po.

11 Py. Kur hynin mrena me ju ra n'shuplaka, apo me ju rreh, sa
12 vetë hynin me e bo këtë punë?

13 Pë. Tash me i majt men, kan ndodhur në ora tre, shembull, një
14 natë, a nodh, nga 4 - 5, krejt t'armatosur, me uniforma, jonë
15 hy, na kanë sha, na kanë -- gjithfarësoj gjanash, na kanë kanë
16 ra ka një shuplakë, ka dy, ka shkelma, Ç'ashtu kan ba.

17 Py. [REDAKTUAR] pati ndonjë t'nxime, a ju nxi syri, a ndonjë
18 dhimbje në krah, në këmbë, nga këto të rrafme me sa di ti?

19 Pë. Jo.

20 Py. S'kishte as të nximë në kështu, në lëkurë, as dhimbje
21 gjëkundi?

22 Pë. Vallahi, dhimbje ka pasur ai, thejke po më dhemb kama, po
23 m'dhemb dora, une s'kam parë që kanë bo noj far shenjash.

24 Py. Aty brenda në haur, ju vetë a mund të shinit jashtë
25 përmes ndonjë dritareje, apo nëse kishte dritare, ajo dritare

1 ishte shumë larg dhe nuk shikonit dot jashtë? Nuk e di a mund

2 të na thuash?

3 Pë. Jo, s'kena pa hiç. Nuk më kujtohet. S'di as që ka pas

4 dritare, m'pas pa sikun një shumë e vogël. Diçka ka pas.

5 Py. E kuptoj. Pasi erdhi ai zotëria që na fole më herët, na

6 the se askush tjetër nuk u rreh më. Kështu ka qenë?

7 Pë. Po. [E padëgjueshme].

8 Py. Duke përfshirë [REDAKTUAR], ë?

9 Pë. Urdhno?

10 Py. [REDAKTUAR] Pra edhe [REDAKTUAR] nuk u rrahën më mbas

11 asaj kohe.

12 Pë. Po, jo asnjë person ma s'na ka rreh. Se me siguri a kone

13 njëri që s'kanë guxur me na rreh. Nuk e di kush a konë ai.

14 Py. Me sa kuptova, [REDAKTUAR] ishte rrehur më përpara shumë,

15 egërsisht. Kur e pe ti herën e parë, pra kur e pe herën e

16 parë, e kishin pas rreh shumë. Kështu është?

17 Pë. Po.

18 Py. Sepse në fakt ai ishte personi i parë që pe ti, kur

19 arrite aty, tek ai vendi. Kështu?

20 A mund t'i përgjigjesh, pra, kështu ka qenë që ai ishte i

21 pari, se s'e dëgjova përgjigjen, - thotë.

22 Pë. Po. Po. Po

23 Py. Kur e pe për herë të parë [REDAKTUAR], a të ka përmendur

24 ai ty se sa kohë kishte që rrinte aty?

25 Pë. Jo, unë e kom tregue, kur më kanë shti në atë haurin e

1 parë, kur jom hi mrena ma kanë heq thesin në krye, që kom pas,
2 edhe kom pa një person, i ratë, une kom mendu se është i
3 vdekur, jo i gjallë. Atëherë mbas një kohe, ata veç më kanë
4 shti në dhomë aty, ç'atë, dhe i ndal. I ka çu kryet e m'ka
5 thanë n'emër, tha -- veç m'ka thanë, tha "Kanë me t'myt".
6 Q'aq. Ma shumë s'kam fol me të se s'kena guxu. E mendoshim se
7 po na ndin te dera dikush e po hyn e na myt menjëherë.
8 Py. A ndigjove ndonjëherë prej tij, mbase më vonë, kur ti e
9 ke ndihmu me hangër diçka, e ke ushqy, a po në ndonjë rast
10 tjetër. Pra a të ka thënë ai ty se kishte shumë kohë që rrinte
11 aty përpara se të vije ti?
12 Pë. Jo, vallahi, s'kena bisedu, për atë punë s'kena bisedu
13 hiç, nuk e di.
14 Py. Mirë në rregull, edhe një herë. Tani ishte hera e parë
15 kjo, rasti i parë pra, kur të futën te hauri. Pastaj shkove
16 bashkë me [REDAKTUAR], të çuan te hauri i dytë.
17 Pë. Po.
18 Py. Dhe ke hauri i dytë edhe aty të rrahën prapë.
19 Pë. Po.
20 Py. Aty ka ndodhur, gjatë rrahjes, [REDAKTUAR]
21 [REDAKTUAR]?
22 Pë. Po.
23 Py. Kjo ka ndodhur natën, apo ditën?
24 Pë. Natën.
25 Py. Por tani nuk e mban mend më se sa ishin ata që të rrehen,

1 sa veta ishin?

2 Pë. Jo.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam
4 një pyetje, pyetjet që po bëni ju duhen bërë në seancë
5 private? Sepse ai po flet për vete tani. Nuk e di, ndoshta
6 këto pyetjet që po bëni do të çojnë diku që ju mund ta quani
7 me ven të rrini këtu, por...

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, jo, do të kalojmë në seancë
9 të hapur.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë po ju
11 kujtoj, e keni ju në dorë të vendosni.

12 Zonja Sekretare, të lutem, a kalojmë në seancë publike.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar, jemi në
14 seancë të hapur.

15 [Seancë e hapur]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Vazhdoni, ju lutem.

18 Z. VON BONE: [Përkthim]

19 Py. Kur të rrahën për herë të dytë, prapë e kishe atë thesin
20 në kokë?

21 Pë. Në q'atë kohë që më kanë rrah, ma kanë hjek thesin, si më
22 kanë çuar në këmbë ata apet ma kanë vu thesin.

23 Py. Nga ato që the ti, unë kuptova që të ra alivani kur të
24 rrehen për herë të dytë. Disa herë të ka rënë alivani. Kështu

1 ka ndodhur?

2 Pë. Po.

3 Py. Gjatë rrahjes, a kishe mundësi me i pa se kush ishin ata,
4 pra me i pa kryesit, pra ata që po të rrishin?

5 Pë. Jo, se a konë natë, terr. S'kam mujt me pa kurrgjë, terr
6 a konë, nëpër terr me kanë rref.

7 Py. Për shembull, kur po të rrihnin, a mundeshe me pa nëse
8 kishte ndonjëri mjekër apo syze, apo ndonjë gjë tjetër?

9 Pë. Po, kom vrej, njeni ka pas mjekrën e madhe.

10 Py. Po gjyslyke, kishte ndonjëri syze?

11 Pë. Po, më duket që po, nuk jam i sigurt. Po, kom harru, moti
12 kjo punë është.

13 Py. E kuptoj. Kur po të mernte në pyetje Prokurori, të pyeti
14 nëse është përmendur ndonjë emër kur ata kanë fol mes veti?

15 Pë. S'më kujtohet.

16 Py. Të ta freskoj mendjen, po lexoj nga ato që the ti në
17 faqen 31 të transkriptimit, kur folët [REDAKTUAR]. Ti the
18 "gjatë rrahjes -- që përshkrove -- të pyeti Prokurori, a i
19 përmendën ndonjë emër ata që po të rrihshin mes vetit? Ti the
20 jo. Nuk përmendën emra.

21 Pë. Jo.

22 Py. Pra, do të thuash që kështu është, nuk kanë përmendur
23 emra, nuk i janë drejtuar njëri tjetrit me emra?

24 Pë. Jo.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më

1 fal, zoti Von Bone, duhet ta bëj të qartë se unë e kuptova atë
2 që tha Dëshmitari por shoh Prokurorin që është çuar në këmbë.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nuk dua të ndërpres kolegun e
4 nderuar, por ka dy gjëra që duhet të them. Kolegu i nderuar po
5 përmend transkriptimin. Do të ishim shumë të kënaqur të
6 shihnim se cilën pjesë me saktësi po përmend. Sepse ishte një
7 transkriptim me 110 faqe, kështu që do ta vlerësonim shumë të
8 na thoshte faqen e saktë.

9 Çështja e dytë është, dje dhe të hënën Dëshmitari na
10 tregoi, foli për dy kohë të ndryshme kur është rrahur dhe
11 donim ta dinim se për cilin e ka fjalën, për cilin nga këto dy
12 raste e ka fjalën kolegu i nderuar, sepse duket sikur po flet
13 për herën e parë që e kanë rrahur, por nga pyetjet që po bën
14 duket sikur e ka fjalën për të dytën. Edhe ju kolege e nderuar
15 e përmendët herën e parë. E bëj këtë ndërhyrje sepse dua që të
16 mos ngatërrohet Dëshmitari kur t'i kujtojnë ato që ka thënë
17 gjatë pyetjeve që po i bëjnë. Faleminderit.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Po lexoj nga faqja 31 e
19 transkriptimit.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
21 Dëshmitar, e dëgjove pyetjen time?

22 Ata kur po të rrihshin - atë që po të rrihshin - nuk dua
23 të përdor - ata kryerësit, fjalë për fjalë, ata pra personat
24 që po të rrihshin, a i drejtoheshin njëri-tjetrit me emër kur
25 flisnin me njëri - tjetrin?

1 DËSHMITARI: Jo, ni herë, në një rast vetëm e kom ni, ja
2 ka bo njonit me një emër, unë s'e di se - Tabut, Tabut, ka
3 thanë. Manej s'kom nigju mbas.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Faleminderit, z. Dëshmitar.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë e nderuar
7 Gjykatëse, e gjetët faqen në transkriptim. E shikoj që po
8 pohoni me kokë. Në rregull.

9 Py. Zoti Dëshmitar, ai personi me atë kapelën e kuqe që
10 përmende ti, e di a ishte edhe ai i pranishëm aty ku të
11 rrahën? Ku të vunë edhe pistolën në kokë?

12 Pë. Po.

13 Py. A mund ta përshkruash atë personin? Përveçse kishte një
14 kapele të kuqe. A mund të na thuash diçka tjetër për atë? Të
15 na i përshkruash?

16 Pë. S'di çka me t'përshkru, se po të them se a konë natën, e
17 natën s'jam unë -- kush asht [e pakuptueshme] me - me - me asi
18 aty - S'di.

19 Py. Pra nuk e përshkruan dot?

20 Pë. Nuk di.

21 Py. Faleminderit shumë. Zoti Dëshmitar, po nga e di ti në
22 fakt që i akuzuari ishte njëri prej atyre që po të rrihshin.
23 Pra i akuzuari, klienti im, nga e di ti këtë?

24 Pë. Nga veshja? S'po kuptoj ktu që ka thanë...

25 Py. Po ta them ndryshe. A e di ti nëse ky personi që po

1 akuzohet këtu në gjyq ka qenë një prej atyre që po të
2 rrihshin?

3 Pë. Nuk e di vallahi, apert s'po t'kuptoje. S'kam...

4 Py. Këtu në këtë çështje po gjykohet një person, një i
5 akuzuar. Ai person, pra i akuzuari, është klienti im dhe unë
6 po të pyes ty "nëse ti e si që klienti im, i akuzuari, ka qenë
7 një prej atyre personave që të rrehshin ty atë natë".

8 Pë. Po. Shumë e kjarhtë që po.

9 Py. Po nga e di ti këtë që po thu?

10 Pë. Po unë e di se une e dija se ma vonë, e di që kryesori a
11 kone q'at personi. Domethënë, kurrë më n'jetë s'e kom pa, po
12 n'jashtë, kur i kanë ndez do bateria aty, kani herë e kom pa
13 si person, por s'më kujtohet. Se a kanë terr.

14 Edhe kush, logjikisht, tjetër kush s'ka pas me m'rreh pos
15 ai, ai a kanë kryesori aty. Ai çka ka thonë, o bo aty.

16 Py. Por ti thua se s'e ke njohur atë person përpara, s'e ke
17 parë më parë?

18 Pë. Kurrë, me sa aty a t'kom njoh që po t'shoh sot [e
19 pakuptueshme].

20 Py. Dhe ai nuk t'u prezantua ty me emër, nuk ta tregoi se si
21 e quanin.

22 Pë. Jo bre, çfarë të prezantimi!

23 Py. Pra po të pyes përsëri, nga e di ti se i akuzuari është
24 personi që po të rrihte ty atëherë? Dua ta di, më thua nga e
25 dije ti. Nga e di ti që ishte ai? Ti nuk e njihje më parë atë

1 person, prandaj më shpjego pak të lutem nga e di, nga e di ti
2 që ishte i akuzuari?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
4 Dëshmitar, të lutem prit deri sa të përfundojë pyetja, sepse
5 duhet ta përkthejmë, që ta kuptosh.

6 DËSHMITARI: A muj me fol?

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
8 mund të flasësh.

9 DËSHMITARI: Zotëri, atë personin, që ma përmende njëqind
10 herë dhe nuk keni nevojë të ma përmendni aq shumë herë, po
11 t' thom të drejtën, unë e kom tregue se atë nuk e kom njoftë as
12 nuk e kom ditë, as kush është, as çka a problemi me atë. Më në
13 fund nuk jam budall, e kom ditë kush asht. Ai zotëria që po e
14 mbron ti, është qi ky, se s' muj me thonë ty ose dikujna ktu -
15 po q' aj asht. Dhe mos më qit më kësisoj pyetje se po më duket
16 pak pa lidhje.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua
18 t' i drejtohem Dëshmitarit.

19 Zoti Dëshmitar, Mbrojtësi është këtu për të bërë pyetje
20 ty, për të të bërë pyetje. Dhe pyetjet janë me vend për
21 Mbrojtjen. Janë pyetje që duhet të bëhen dhe ti përgjigju siç
22 mendon ti, por pyetjet duhet të t' i bëjë avokati i Mbrojtjes.
23 Vazhdoni.

24 Z. VON BONE: [Përkthim]

25 Py. Pra po të pyes përsëri, nga e di ti që ishte ai akuzuari

1 ai person? Ai që po të rrihte?

2 Pë. Më duket që e kallzova vetë, ka e dij. Tregova.

3 Py. Pra a do të përgjigjesh edhe një herë nga e di që ishte i
4 akuzuari ai? Prit një çikë, prit pak.

5 Pë. E kom mor shumë mirë vesh kush o konë kryesori në q'at
6 ven q'aty. Edhe mund me kon vetëm ai, e kurrkush tjetër.

7 M'duket t'u përgjigja një herë.

8 Py. Pra, në atë kohë nuk e dije vetë, por kur dole më vonë
9 nga burgu, e mësove prej të tjerëve, këtë po na thu?

10 Pë. Po.

11 Py. Nga kush e ndigjove? Nga kush e mësove?

12 Pë. Nuk është me rëndësi me t'kallzu ka kush, shumë njerëz ka
13 pasur, kanë ditë krejt tani në fund.

14 Py. Mendoj që është me rëndësi, z. Dëshmitar, dhe dua që t'i
15 përgjigjesh edhe kësaj pyetje.

16 Pë. Po nuk e di a konë, se s'muna me dhanë emna të huaj këtu.
17 Po e mora -- unë vetë për veti me dhonë dëshmi, jo për kërkën.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë dua që të futemi në seancë
19 private të nderuar Gjykatës.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
21 na jep shpjegim kur të jemi në seancë private, pse kërkon të
22 jemi në seancë private.

23 Të futemi në seancë private, ju lutem.

24 SEKRETARJA E GJYKARTËS: [Përkthim] Jemi në seancë
25 private.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në kundërpjetje nga Z. Von Bone
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Page 21

1 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit, zonja Sekretare.

4 Avokati i Mbrojtjes, po të flas unë, nuk isha e qartë. A
5 mund të na shpjegoni se përse kërkuat të futemi në seancë
6 private?

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Mbase Dëshmitari do të ndihet më
8 rehat të përmendë njerëz me emra po të jemi në seancë private,
9 se mbase kjo është arsyeja që s'po i jep emrat. Dua të
10 sigurohem që dëshmitari është plotësisht rehat.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit për shpjegimin. Kur të futemi në seancë private,
13 u kërkoj palëve jo vetëm juve, që të më shpjegojnë arsyen pse
14 duhet të futemi në seancë private, sepse kjo më ndihmon për të
15 marr vendim. Dua që publiku të marrë pjesë, duke parë këtë që
16 po ndodh këtu në gjyq.

17 Z. VON BONE: [Përkthim]

18 Py. Zoti Dëshmitar, tani jemi në seancë private, që do të
19 thotë që asnjëri nuk të dëgjon ato që do të thuash jashtë
20 gjyqate. Vetëm ne këtu jemi. E kupton?

21 Pë. Po.

22 Py. Pra po të pyes përsëri z. Dëshmitar, a mund të na i
23 tregosh emrat e atyre njerëzve që të thanë se ishte i akuzuari
24 ai që të ka rrahur dhe që ishte personi më i rëndësishëm aty?
25 Kush janë këta njerëz që t'i kanë thënë këto gjëra?

1 Pë. Nuk muj me ta tregu asnjë person se nuk kam nevojë me
2 tregu.

3 Py. Zoti Dëshmitar, është në fakt e vërtetë që disa njerëz
4 t'i thanë këto apo mbase s'është aspak e vërtetë kjo që po
5 thua?

6 Pë. Po e vërtetë është [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 Py. Pyetja që kam për ty është kjo edhe një herë: "Përse nuk
9 na i thënke dot këta emrat e atyre që të kanë treguar se i
10 akuzuari ishte personi kryesor? Pse s'na i thua dot?".

11 Pë. Pse, nuk e di vallahi, pse. Se kom harru, ndoshta s'kam
12 dit, se jom konë -- nuk a kom normal, absolut, edhe q'ta nuk
13 jam kiartë. Veç ç'i ta - [e pakuptueshme].

14 Py. Me këtë do të thuash që i ke harruar emrat e q'atyre që
15 t'i kanë thënë këto fjalë?

16 Pë. Edhe i kom harru edhe as nuk du me ta përmend. S'kam
17 nevojë me m'morr hall n'kët mënyre, këtu me përmend. Me i marr
18 vesh personal për veti, jo për këtë hall.

19 Py. Ti ke ardhur këtu si Dëshmitar, zoti Dëshmitar dhe je
20 betuar që do të thuash -- dhe mendojmë se është një pyetje me
21 rëndësi se kush të ka thënë e si ta kanë thënë. Pra po të pyes
22 përsëri, kush të ka thënë kështu.

23 Pë. [REDAKTUAR]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
25 falni që po ju ndërpres, por dua t'i drejtohem Dëshmitarit.

1 Zoti Dëshmitar, tani po të flas unë, Gjykatësja. Ti je
2 betuar për të thënë të vërtetën dhe nuk duhet të mbash
3 informacione. Në qoftë se e ke harru, thuaj që e kam harru. Në
4 qoftë se ke informacion që duhet ta tregosh, duhet ta thuash
5 këtu.

6 Tani ja jap fjalën prapë avokatit të Mbrojtjes.

7 Z. VON BONE: [Përkthim]

8 Py. Po ta përsëris pyetjen, zoti Dëshmitar, kush të ka thënë
9 se ishte i akuzuari person kryesor aty dhe se ka marrë pjesë -
10 - ishte ai që ka marrë pjesë në rrahjen tënde. Kush ta ka
11 thënë këtë?

12 Pë. Nuk e di, s'e mbaj mend?

13 Py. Zoti Dëshmitar, në cilin rast ka ndodhur që ata njerëzit
14 që ti s'i mban mend, të kanë thënë? Në çfarë rasti ka qenë që
15 ta kanë thënë këtë?

16 Pë. Po, kur a kry lufta, atëherë kam ndejt me lloj-lloj
17 njerëz. Me fshatarët e mi, sikur çdokush që rri. Edhe un jam
18 bindur 100% që qi ky person a konë kryesori në q'atë [e
19 pakuptueshme] q'aty në Zllash.

20 Py. Në çfarë rastesh ka ndodhur që ke folur me dikë, në
21 shtëpinë tënde ka ndodh kjo apo në shtëpinë e dikujt tjetër,
22 apo në një bar, apo - kur, kur ta kanë thënë këtë gjë?

23 Pë. Po e kom bisedu [REDAKTUAR]. Kom
24 bisedu edhe me dikan kshtu, po ajo normale asht. E ku, qysh,
25 tek, ato janë që në 20 vjet, tybe jan harru, nuk di çfarë kam

1 hangër mbramë.

2 Py. Zoti Dëshmitar, a e di ti, a di ti nëse ndonjë prej
3 njerëzve me të cilët ke fol, kishin pasur vetë ndonjë kontakt
4 me të akuzuarin, me klientin tim?

5 Pë. Nuk di.

6 Py. Pra asnjë prej njerëzve me të cilëve ti ke folur?

7 Pë. Jo.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
9 avokat. Sapo lexova edhe një herë përgjigjen e Dëshmitarit. Ti
10 e pyete për asnjë prej njerëzve me të cilët ti ke folur, por
11 ai u përgjigj pak më lart "Unë nuk e di, nëse ndonjë prej
12 njerëzve me të cilët ke folur ti kishte ndonjë kontakt me të
13 akuzuarin". Ai ka thënë "Nuk di". Pastaj ka thënë "Asnjë". Ai
14 thjesht mund të ketë përgjigjur atë që the ti, por i është
15 përgjigjur ama pak më herët. E them këtë se nuk dua që ta
16 ngatërrojmë Dëshmitarin me pyetje si këto.

17 Z. VON BONE: [Përkthim]

18 Py. The që me familjen e ke diskutu, brenda në familje.
19 Ndonjë prej anëtarëve të familjes tënde, a e ka njoft
20 ndonjëherë të akuzuarin?

21 Pë. Jo.

22 Py. Ndonjë prej miqve të tu, apo kushdo tjetër me të cilët ti
23 e ke diskutuar këtë punë, a e kanë njoft a e kanë taku
24 ndonjëherë të akuzuarin?

25 Pë. Jo.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në kundërpjetje nga Z. Von Bone Faqe 25
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
2 avokat i Mbrojtjes. Dëshiroj të kalojmë në seancë publike nëse
3 s'ka problem?

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Pa problem.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja
6 Sekretare, mund të kalojmë sërish në seancë publike?

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
8 jemi rikthyer në seancë publike.

9 [Seancë e hapur]

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit shumë.

12 Zoti Von Bone, ke fjalën.

13 Z. VON BONE: [Përkthim]

14 Py. Pra, e ke dëgjuar për njerëz të tjerë të cilët ta kanë
15 thënë, ta kanë tregu, nuk do t'u thush emra, nuk ua di më
16 emrat, nuk di nëse kishin apo jo kontakt me këta, por mund t
17 ketë qenë komplet dikush tjetër që ta ka bërë këtë gjë.

18 Pë. Jo.

19 Py. Pse jo?

20 Pë. Pse jo? Se nuk -- nuk di.

21 Py. Për se jo?

22 Pë. Po zotëria, a ki tjetër pyetje me m'dhanë? Ma çon ditën
23 ktu me ni pyetje, po bon. Nuk e di pse kështu po më ban.

24 Py. Dua t'i përgjigjesh kësaj pyetjeje, përse -- përse mund
25 të mos jetë kush tjetër?

1 Pë. Po mos ma pyet ma po atë pyetje. Pyet kot.

2 Py. Ti nuk the që nuk e di. Unë thjesht thashë pse nuk mund
3 të jetë kush tjetër, ti tani thua nuk di.

4 Pë. Nuk di se jemi [REDAKTUAR], harrojmë, nuk di kurrëgjë.
5 Prandaj.

6 Py. Nuk ka problem nëse harron diçka apo nëse nuk e di diçka.
7 Nuk është ky problemi, por pyetja që kam është e thjeshtë. Pse
8 nuk mund të mos ketë qenë dikush tjetër?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Avokati i Mbrojtjes, shikoj që edhe Prokuroria edhe Mbrojtësja
11 e Viktimave janë ngritur në këmbë, por edhe Gjykatësit duan që
12 të diskutojnë diçka.

13 Në fillim ua jap juve fjalën. Të dy juve pastaj do të
14 këshillohem me njëri tjetrin.

15 Zoti Prokuror, keni fjalën.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Shumë shkurt. Dëshmitarit disa
17 herë i kanë bërë të njëjtën pyetje dhe dy a tri herë ka dhënë
18 një përgjigje të njëjtë. Unë mendoj nuk ka kuptim të harxhojmë
19 kohë të vazhdojmë më tutje.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
21 dëgjova, po.

22 Mbrojtësja e Viktimave, ju lutem.

23 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit, ashtu vërtetë, është
24 rregulla 143, të cilën po e shoh tani dhe nuk ma merr mendja
25 se pyetje të tilla, nëse i përsërisim do të çojnë në gjetjen e

1 së vërtetës dhe unë mendoj se është shumë mirë, e ilustron
2 shumë mirë këtë rregull, kështu që unë mendoj se nuk ja vlen
3 që të merremi më gjatë me këtë, nuk do të hedh më shumë dritë
4 për këtë. Prandaj unë kundërshtoj vazhdimin e këtyre pyetjeve.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] A mundem shumë shkurt?

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Patjetër.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Ndonjëherë Dëshmitari thjesht
9 refuzon të përgjigjet, nuk do të përgjigjet ose thotë nuk
10 mundem ta them, nuk e di, këto nuk janë -- është përgjigje,
11 por kur thotë që nuk dua të them, nuk dua të them emra të
12 tjerë, të paktën ne e dimë që di emra dhe nuk do të na tregojë
13 emra. Bëjmë seancë të hapur, seancë të mbyllur, në çfarë do
14 lloj seance në të cilën mund të krijonte kushte ku të ndihej
15 rehat.

16 Por unë mendoj se është e rëndësishme kur në këtë gjykatë
17 ne përpiqemi që të gjejmë të vërtetën se çfarë ka ndodhur.
18 Ndonjëherë, madje duhet t'i bëjmë edhe pyetje të vështira
19 Dëshmitarit. Dëshmitari është betuar, dhe duhet t'u përgjigjet
20 pyetjeve dhe nëse nuk është i gatshëm t'u përgjigjet pyetjeve,
21 nëse nuk ka dëshirë që t'u përgjigjet pyetjeve, duhet të
22 marrim masa që t'u përgjigjet pyetjeve se nuk duhet lënë në
23 dorë të Dëshmitarit që të thotë "nuk dua me jua thënë ose nuk
24 ka me u përgjigj". Është e qartë që kështu ka -- kështu ka
25 treguar, dhe po ngul këmbë për këtë. Unë mendoj se Mbrojtja e

1 ka këtë të drejtë, Avokati i Mbrojtjes e ka këtë të drejtë.
2 Por kjo vlen edhe për të gjetur të vërtetën e për të kuptuar
3 nëse po thotë të vërtetën apo jo. Se këtë duam të konstatojmë,
4 të gjejmë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit për parashtrimin tuaj. Shoh Mbrojtësja e
7 Viktimave është ngritur në këmbë. Madje bëni mirë ngiheni në
8 këmbë sepse e kuptoj më mirë kush e do fjalën.

9 ZNJ. PUES: [Përkthim] Një përgjigje të shkurtër kolegut
10 të nderuar.

11 Unë nuk mendoj se ajo që ai tha e pasqyron saktë atë që
12 pamë këtu, pra sikur dëshmitari sikur refuzon, sikur nuk do të
13 përgjigjet. Ai i ka dhënë shpjegimet e veta. Pse është kaq e
14 vështirë që të na japë informata të tjera, po flasim për një
15 gjë që ka ndodhur 22 vjet më parë. E kemi dëgjuar se ai ka
16 përshkruar për shumë njerëz në një situatë ku asgjë nuk ishte
17 normale. Mos harroni, siç e tha edhe ai vetë, ishte një
18 situatë në mes të luftës, kur gjërat nuk ishin normale.

19 Prandaj unë kundërshtoj kur Avokati i Mbrojtjes thotë që
20 ky Dëshmitar nuk po bën çmos që të na japë neve informacionet
21 që ka.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuara Gjykatëse, nëse
23 mundem.

24 Dëshmitari që ditën e parë i tha Prokurorit: "e di, e di
25 këtë, e di që kështu është" dhe Prokurori e mori përgjigjen pa

1 e dyshuar. Po si mund ta gjemë ne të vërtetën për një fakt të
2 veçantë nëse është fakt, pra nëse është gjë e vërtetë apo nëse
3 nuk është e vërtetë, nëse nuk fakt. Nëse është besim, pra
4 ashtu beson dëshmitari, apo nëse ai mendon se është e vërtetë,
5 duke ja thënë dikush tjetër dhe jo se është fakti i vërtetë.
6 Kur dikush thotë që është fakti i vërtetë, mendoj se është e
7 rëndësishme të vërtetohet se si e ka zbuluar këtë fakt
8 dëshmitari. Nga e di dëshmitari që është kështu e vërteta.

9 Sepse çështjet penale kur hetohen e gjykohen krime,
10 kështu veprohet. Jo siç veproji Prokurori "Po, faleminderit për
11 përgjigjen" dhe kaq. Unë dua të ngul këmbë në këtë pikë sepse
12 është me lidhje për ne, sepse kur një person akuzohet dhe
13 gjykohe, dhe Dëshmitari thotë që "po ky ishte" por mund të
14 mos ketë -- dhe pastaj nuk ka një shpjegim të arsyeshëm se ku
15 e di dëshmitari se vërtet ishte ky, nga e ka gjet që ishte ky.

16 Unë mendoj se kështu duhet bërë gjyqi penal, gjyqi
17 krimeve dhe jo duke thënë që "oh, po ka kaluar shumë kohë"
18 etj.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ju
20 ndërpres, zoti avokat. Herës tjetër kur të bëjmë diskutime të
21 tilla do t'i lutem -- do kërkoj që Dëshmitari të mos dëgjojë.

22 Ju kuptoj, zoti Avokat i Mbrojtjes. Dëgjova edhe fjalët e
23 Prokurorisë dhe të Mbrojtëses së Viktimave. Me thënë të
24 vërtetën, për mua, pyetja që ju bë Dëshmitari, pra mund të
25 ketë qenë komplet një njeri tjetër që mund ta ketë bërë këtë,

1 nuk ndjek logjikën e pyetjes pastaj që kishe bërë përpara.
2 Pyetje mund të bëni, mund t'i bëni pyetje Dëshmitarit, se
3 çfarë ka ndodhur, kë ka parë, apo kush ka qenë ai që e ka
4 rreh, apo që ka dhënë urdhër me e rreh, që thotë ai, por për
5 mendimin tim, unë do t'i kisha ndaluar aty kur thatë "por mund
6 të kishte qenë edhe dikush tjetër që ta kishte bërë këtë gjë"
7 sepse s'e kuptova, nuk mu duk e logjikshme lidhur me pyetjet
8 që kishit bërë më përpara. Duhet të tregoni kujdes.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Po sepse, e nderuara Gjykatëse,
10 ai mbase dikush e mendon se është ashtu, se është ai person,
11 por mund të ketë -- dhe nga të menduarit -- kujton se është
12 ashtu, pastaj kujton se është e vërtetë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
14 Dëshmitar, a mund t'i heqësh dëgjueset nga koka, të lutem?

15 Po, ju kuptoj dhe do t'ju jepet mundësia që të t'i bëni
16 pyetjet që i konsideroni të nevojshme, por unë siç e shoh
17 situatën është kështu: Dëshmitari një shpjegim e ka dhënë, po
18 të keni pyetje të tjera për të njëjtën temë, do t'ju lejoj,
19 sepse janë të nevojshme. Por mos bëni të njëjtën pyetje nëse
20 ai e ka dhënë një shpjegim, se si e ka dëgjuar, se atë
21 shpjegim ai e ka dhënë.

22 Nëse doni ta verifikoni me një mënyrë tjetër dijeninë e
23 tij, sepse unë e pash që ju pyetët për personat me të cilët ka
24 fol për anëtarët e familjes, këtë e kuptoj por mos përsërisni
25 të njëjtën pyetje. Sepse fakti që Dëshmitari nuk do t'i

1 përgjigjet pyetjes ai është këtu që të përgjigjet sigurisht
2 por unë dua që të mos përsërisni të njëjtën gjë. Pra për
3 pyetjet që ai është përpjekur t'u përgjigjet po t'i shpjegojë.
4 Të tjera, po, mund t'i bëni, por të ngulni këmbë të bëni të
5 njëjtën pyetje katër herë, kjo vetëm sa e bën atë të ndihet më
6 keq dhe nuk kuptojmë, nuk besoj se kjo mund t'ju japë më shumë
7 informacione.

8 Unë do të këshillohesha me kolegët, pro do këshillohem në
9 një moment tjetër.

10 Mund të vijoni tani.

11 Zoti Dëshmitar, do të vazhdojmë prapë me pyetjet dhe e ka
12 rendin avokati i mbrojtjes.

13 Z. VON BONE: [Përkthim]

14 Py. Zoti Dëshmitar, a e ke verifikuar ti vetë informacionin
15 që ke marrë prej të tjerëve lidhur me të akuzuarin?

16 Pë. Po.

17 Py. Si e ke verifiku?

18 Pë. Po krejt ushtria që a konë në Zllash e dinë që qi ky
19 person a konë aty kryesori. Jo është një person, po e dinë
20 krejt. Edhe ju e dini më mirë se unë, shumë mirë e dini. [e
21 pakuptueshme] as unë s'e kom pru kto ktu, kush e ka pru nuk e
22 di. [E pakuptueshme] interesum për të. Unë nuk po thtom se unë
23 duhet mu përgjigj pyetjeve të mia, kush më ka rreh, kush më ka
24 bo, ne manej nuk di. Nuk di.

25 Py. Të kuptoj. Po unë të pyeta si e ke verifikove, si e

1 kontrollove ti vetë që fjalët që t'i thanë të tjerët ishin të
2 sakta apo të pasakta, për diçka, nga -- si e verifikove, e
3 kontrollove ti këtë?

4 Pë. Vallahi unë s'mujti me t'u përgjigj, ndryshe nuk di qysh.

5 Py. Nuk e ke taku më të akuzuarin, s'je taku ndonjëherë me të
6 akuzuarin ndonjëherë në jetë. Nëse -- po të të them edhe unë
7 ty se edhe i akuzuari nuk të ka taku ndonjëherë në jetë të
8 tij, si do të përgjigjeshe?

9 Pë. Unë s'muj me dit se m'ka takue, po s'e kam taku. Unë nuk
10 muj me e ditë. Në jetë teme s'e kom pa ma, as nuk më ka
11 interesu kurrë ma pastaj, hiç.

12 Py. Si do përgjigjeshe po të them kështu që klienti im thotë
13 që ai s'të ka rrah asnjëherë ty në Zllash?

14 Pë. Atëherë më paske rreh ti. Nuk e di kush!

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
16 Dëshmitar, nuk -- në një sallë gjyqi, nuk duhen bërë shaka të
17 tilla, mahi të tilla, dhe sidomos jo Avokatit të Mbrojtjes, të
18 lutem. Më kuptove?

19 DËSHMITARI: A muj me fol?

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Mundesh me fol, po a kuptove atë që të thashë që nuk mund t'ja
22 thuash këtë Avokatit të Mbrojtjes.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Kisha edhe një pyetje tjetër por
24 e mora përgjigjen.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

1 por nuk dua që Dëshmitari t'ju përgjigjet në atë mënyrë. Keni
2 fjalën.

3 Z. VON BONE: [Përkthim]

4 Py. Zoti Dëshmitar, po të them që klienti im më ka thënë se
5 s'të ka rrahur asnjëherë. As në Zllash e askund tjetër. Kësaj
6 si do i përgjigjeshe?

7 Pë. Ai mund me thonë çka të don vetë. Ai e din, une çka fol
8 ai s'mun me msu, ai e din!

9 Py. Zoti Dëshmitar, Prokurorit i the, kur të pyeti, se nga të
10 tjerët ke dëgjuar një muaj mbas lufte.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
12 Von Bone, a mund të na e tregosh ku e ke parë këtë në
13 transkriptin e seancës?

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Oh.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Se
16 është e rëndësishme.

17 Nuk e keni, nuk e dini se ku është.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Një moment ju lutem.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
21 Von Bone, mos të vonohemi, mund të na e tregoni më pas se ku
22 ndodhet që ta dinë palët e tjera, Mbrojtësja e Viktimave dhe
23 Trupi Gjykues.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Faqja 45, më thonë, rreshti 22.

25 Po ta shohim është në ekran faqja 45, është rreshti 22, aty

1 ndodhet.

2 Py. Zoti Dëshmitar, pyetjes që të bëri Prokurori, iu
3 përgjigje se e more vesh rreth një muaj pas datës së lirimit.
4 A të kujtohet se ku e dëgjove për herë të parë këtë gjë? A të
5 kujtohet?

6 Pë. [REDAKTUAR]

7 Py. [REDAKTUAR] Kush të tha? Kush ta tregoi?

8 Pë. Gruaja.

9 Py. Gruaja? Gruaja? A ishte takuar ndonjëherë në jetë të vet
10 me të akuzuarin?

11 Pë. Jo, kurrë.

12 Py. Po a e pyete ndonjëherë gruan a e kishte verifikuar ajo
13 këtë gjë?

14 Pë. [E padëgjueshme].

15 Py. Si t'u përgjigj, si e kishte verifikuar?

16 Pë. Po e ka verifikua se [REDAKTUAR] ku e
17 [REDAKTUAR], q'aty. Dhe ai i ka tregu se kush asht
18 ky.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Duhet
20 të kalojnë në -- një moment, mos vazhdoni.

21 Jemi në seancë publike, duhet të kthehemi në seancë
22 private. Më falni që ju ndërpreva, më fal që të ndërpreva zoti
23 Dëshmitar, më falni që ju ndërpreva zoti avokat, por duhet të
24 kalojmë në seancë private.

25 Zonja Sekretare e Gjykatës, a mund të kalomë në seancë

1 private?

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
3 jemi në seancë private.

4 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit, zonja sekretare.

7 Avokati i Mbrojtjes mund të vazhdoni.

8 Zoti Dëshmitar, po thoshe?

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Më duket se pyetja që bëra të
10 nderuar Gjykatës ishte nëse e pyeti gruan apo jo a kishte
11 verifiku dhe nëse po, si e kishte verifiku, dhe sapo filloi -
12 sa kishte filluar përgjigja.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
14 Dëshmitar, mund të vazhdoni.

15 DËSHMITARI: Po, gruaja e ka verifikue, [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR] ky personi.

18 Z. VON BONE: [Përkthim]

19 Py. Zoti dëshmitar, siç të kuptova, gruas tënde ja kishte
20 thënë dikush tjetër. Kështu?

21 Pë. Po. [E padëgjueshme].

22 Py. Po a e di nëse ky personi tjetër a ishte takuar
23 ndonjëherë me të akuzuarin?

24 Pë. Nuk e di.

25 Py. Faleminderit shumë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Marrje në kundërpjetje nga Z. Von Bone

Faqe 36

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mos është ky
2 momenti për të bërë pauzën sepse do të hyj në një temë tjetër,
3 do të cek një temë tjetër. Mendoj se me këtë temë që kisha
4 tani kam kryer. Mendoj se ky është momenti i duhur për të bërë
5 një pushim.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk e di sa kohë më ka mbetur.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtu
10 më kanë mbetur edhe tre minuta nga kjo seancë kështu që jeni
11 shumë mirë.

12 Zonja Sekretare, të kalojmë në seancë të hapur.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
14 jemi rikthyer në seancë të hapur.

15 [Seancë e hapur]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit shumë, zonja sekretare.

18 Ka ardhur momenti për pushimin e parë. Shoh avokatin
19 mbrojtës se keni përdorur një orë, 42 minuta dhe 65 sekonda
20 deri tani nga koha që ju është caktuar.

21 Zoti Dëshmitar, tani do të bëjmë pauzën. Shoqëruese në
22 sallën e gjyqit do t' i kërkoj që të të shoqërojë që të dalësh
23 nga salla. Do të rishihemi prapë bashkë, do të vini prapë këtu
24 mbas gjysëm ore.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë.

Dëshmitari: W03593 (Vazhdim) (Seancë e hapur)

Faqe 37

Marrje në kundërpyetje nga Z. Von Bone

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 [Dëshmitari largohet nga salla]

2 --- Pauza filloi në orën 10.59.

3 --- Seanca rifillon në orën 11.31.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Përpara sesa të fillojmë sesionin tjetër, përpara se të
6 sjellim dëshmitarin - Z. Von Bone unë ju thashë sesa kohë ju
7 ka mbetur rreth gjysmë ore, por Trupi Gjykues dëshiron t'ju
8 thotë nëse keni nevojë për më shumë kohë sigurisht mund të
9 kërkoni. Nuk është ndonjë problem, nuk është se jemi në dyqan
10 e do blejmë luleshtrydhe.

11 Të fillojmë.

12 Të lutem ftuese merr dëshmitarin.

13 Kur të vijë dëshmitari dua të shoh palët.

14 Shoh në anën e djathtë të njëjtët persona. Edhe nga ana e
15 Mbrojtjes janë të gjithë aty.

16 Shoh që Z. Mustafa gjithashtu je aty. Mirë. Shoh që
17 Përfaqësuesi i Zyrës Administrative nuk është aty për
18 procesverbal. Dhe ne sigurisht si Trup Gjykues jemi po ashtu
19 këtu. Në rregull.

20 [Dëshmitari hyn në sallë]

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT: [Përkthim] Z.

22 Dëshmitar, mirë se ke ardhur përsëri.

23 DËSHMITARI: [E padëgjueshme].

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk

25 dëgjova përkthimin e asaj që tha dëshmitari. A punon mirë

1 sistemi se dëshmitari tha diçka po nuk dëgjova përkthimin.

2 Çfarë the z. Dëshmitar? Çfarë the të lutem kur të thashë
3 mirë se keni ardhur?

4 DËSHMITARI: Faleminderit, mire se ju kena gjete!

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
6 rregull. Do të rifillojmë me bërjen e pyetjeve nga Mbrojtësit
7 e të Akuzuarit.

8 Z. Von Bone, keni fjalën.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë të nderuar.

10 Faleminderit shumë Dëshmitar.

11 Z. VON BONE: Do të flasim pak. Tani jemi në seancë të
12 hapur pastaj do të futemi për pak kohë në seancë private për
13 t'i shpjeguar diçka Dëshmitarit, pastaj do të kthehemi përsëri
14 në seancë të hapur.

15 Py. Z. Dëshmitar, ty të liruan nga ai vendi ku të kishin
16 mbajt. Më mirë tani?

17 Z. Dëshmitar, pra të liruan nga ai vendi ku të mbanin, në një
18 kohë, në një moment dhe për këtë dua të të pyes. Në kohën që
19 të liruan, a e mban mend kur dole jashtë? A mund të na thuash
20 se çfarë pe kur dole përjashta nga ai vendi?

21 Pë. Po më datën 18 - ata e dinë, mbasi jam dalë prej burgu as
22 kom dit datë, as kom dit natë, as kom dit ditë. Jam dalë më
23 duket nga ora 11.00 na kanë çil derën edhe jam dalë.

24 Py. Kur u hap dera, kur u çel dera, ti the më përpara se dole,
25 ishe nga të fundit që dole nga ajo dhoma. A mund të na e

1 përshekruash kur dole? Çfarë pe? Ku u gjende?

2 Pë. Po une jam dalë - mu më kanë thirrë, me emra na kanë

3 thirrë. Unë jom mbetë i treti, dhe dy janë mbetë pas meje. Jam

4 dalë, kur jam dalë në oborr prej atij ahurit, ka konë njerëz

5 plot, që kshu u konë, se u konë ofensiva e njerëzit tu ikë

6 edhe tu kqyr çdo njoni me rujt kokën e vet.

7 Py. A mund të na thuash afërsisht sesa njerëz ke pa atë dite

8 aty jashtë?

9 Pë. Kom pa lloj-lloj njerëz, në rrobe civile, me rrobe të

10 ushtrisë, me rrobe, kshu që ka pasë shumë njerëz.

11 Py. Po mendon se mund të na thuash afërsisht sa veta mund të

12 kenë qenë aty? Si ta merr menja ty sa kanë qenë?

13 Pë. Valla në oborr, që aty ku jom dalë une, nuk i kom njeh, se

14 s'kom pasë kohë, e s'kom pasë nevojë, po janë konë dikund afër

15 60 vetë sigurisht.

16 Py. Z. Dëshmitar, a kishte ndërtesë tjetër aty përjashta?

17 Pë. Nuk kom kqyr bela, nuk di në ka pasë a jo.

18 Py. Këta njerëzit që pe ti aty, çfarë po bënë? Po rrinin aty

19 apo çfarë po bënë?

20 Pë. Po. Ata kanë ardhë prej të tana anëve, kshu janë tubu

21 qaty, edhe na kanë tregue, një person, na ka tregu rruga ka

22 asht me dorë me shku për Prishtinë.

23 Py. Po, koha si ishte, e mban mend? Si ishte koha? Ça moti

24 bënte? Ishte ftohtë a qielli ishte i pastër pa re apo si? Si

25 të mbahet mend ty?

1 Pë. Ka konë më duket mesatare. Nuk a konë ftoftë. Normal.

2 Py. A ta merrte menja ty se kishte ndonjë ndërtesë tjetër
3 përveç asaj ku ju kanë mbajt ju?

4 Pë. Po, po ka pasë.

5 Py. A mundesh me na i përshkru ato ndërtesa që ke pa aty
6 përjashta?

7 Pë. Po ato normal janë konë keq si ndërtesa që kom ndejt unë
8 aty, qasi dishka. Sa janë konë nuk e di se si kom ngjofte. Unë
9 mendoj se s'më ka interesu me kqyr, por më ka interesue për me
10 dalë prej aty, ka po na thojnë me shkue, na kanë thonë rruga,
11 na kanë tregu me dorë, që anejna për Prishtinë se se kom ditë.
12 Edhe aq u kom i hupur sa se kom dite ka me shku. Po ka janë
13 shku krejt njerëzit jam shku edhe unë, me shumë njerëz.

14 Py. Të flasim për atë momentin që të kanë liru, del jashtë,
15 shef njerëz aty, por ajo që më intereson mua është nëse ke pa
16 ndërtesa të tjera si të thashë, përveç asaj nga ku dole?

17 Pë. Po kom pa përsa jom konë aty. Bela nuk e di a janë konë
18 një, a dy, a tri a, nuk e di s'janë konë fort larg. Kështu u
19 konë nja, s'po di, nja 50-60 metra larg. Larg janë konë ato
20 ndërtesa.

21 Py. Ajo rruga që bëre ti, terreni, ishte i shtruar, ishte
22 fushë, apo iu ngjite ndonjë kodre, a iu zbrite nga një kodër?
23 Mund të na i shpjegosh pak si qe terreni aty?

24 Pë. Jo, aty, kur kena fillu prej asajna ndërtesës që kom ndejt
25 une, a konë rrugë, rrugicë. Kanë ecë kështu, jo shumë rrugë e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (Vazhdim) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në kundërpjetje nga Z. Von Bone
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 41

1 parë hiç s'a konë, ma shumë a konë bari, livadh ku kena fillu
2 prej aty. E na dalim rrugë pak më anejna, pak si e mirë, ajo
3 ka vazhdue deri për Prishtinë.

4 Py. Përpara se të të arrestonin a kishe qenë ndonjiherë ke ky
5 veni ti më parë?

6 Pë. Po, unë mendova që jom konë nganjëherë aty kom kalue se

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
10 falni! Kjo duhet redaktuar kjo pjesë. Është punë e punonjësve
11 ligjorë.

12 Dëshmitar -- jemi në seancë të hapur tani. Të lutem kij
13 kujdes kur tregon gjëra që mund të lidhen me vendin ku ti
14 banon.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Tani kërkoj të futemi në seancë
16 private sepse dua t'i shpjegoj disa gjëra dëshmitarit. Pastaj
17 do të kalojmë përsëri në seancë të hapur e do ta udhëzojmë
18 dëshmitarin sesi do të vazhdojmë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Kalojmë në seancë private tani ju lutem.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

22 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit. Avokati i Mbrojtjes e ke fjalën.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në kundërpjetje nga Z. Von Bone Page 42
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Py. Z. Dëshmitar, më pas do të bisedojmë pak për atë
[REDAKTUAR]

2 Unë po e quaj kështu, "ai burri që mbeti pas", më vonë kur të
3 jemi në seancë të hapur që të mos ia them emrin. Pra do ta
4 quaj "personi që mbeti mbrapa". A do ta kuptosh kur të të them
5 kështu? Do të të them "ai burri që mbeti pas".

6 Pë. Dy burra janë mbetë pas meje.

7 Py. Po. Po e kam fjalën për [REDAKTUAR] vetëm në këtë rast.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
9 t'ia shpjegoj dhe njëherë Dëshmitarit që të sigurohemi.

10 Z. Dëshmitar, - po të flet Gjykatësja. Avokati i
11 Mbrojtjes do të të bëjë disa pyetje [REDAKTUAR], por nuk do ta
12 [REDAKTUAR] kur të të pyesi, po do ta quajë "ai burri që mbeti
13 prapa". Nuk do t'ia thotë emrin, sepse nuk ia themi dot emrin,
14 që të mos e marrin vesh të tjerët. E kupton çfarë po të them?

15 DËSHMITARI: Po. Shumë mirë. Shumë mirë.

16 Z. VON BONE:

17 Py. Pra kur të flas për të, do të flas dhe për fshatin ku
18 jetonte ai burri që mbeti pas dhe prindërit e burrit që mbeti
19 pas. Kur të flas për këtë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Avokat, e shoh që po bëni një përpjekje, por kam frikë se nuk
22 do t'ia dalim mbanë dhe në fakt është me shumë rëndësi.

23 Unë parapëlqej që të gjitha pyetjet që do t'i bëhen lidhur
24 [REDAKTUAR], t'i bëjmë në seancë private, sepse rreziku është
25 shumë i madh.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në kundërpjetje nga Z. Von Bone Page 43
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull.

2 Atëherë të kalojmë shkurtimisht në seancë të hapur,
3 pastaj kur të filloj ato pyetjet e tjera të kalojmë në seancë
4 private. Do kalojmë sa te njëra te tjetra.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
6 mua s'ka problem. E rëndësishme është që të ruhet
7 konfidencialiteti. Të kalojmë në seancë publike.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë të
9 hapur.

10 [Seancë e hapur]

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit.

13 Keni fjalën.

14 Z. VON BONE:

15 Py. Z. Dëshmitar, kur të liruan shkove në Prishtinë. A mund të
16 na thuash se çfarë rruge ndoqe, nëpër cilat fshatra kalove
17 para se të shkoje në Prishtinë? Pra të na përshkruash rrugën
18 që ke ndjek.

19 Pë. Po. Kam fillue prej venit ku kom banu, ku kom nejt aty,
20 edhe kam shkue nëpër një fshat. Më ka dalë jasht mendtë, me
21 thonë të drejtë. Po fshati thirret Cervadik. Dhe pastaj jom
22 shku në një fshat, thirret Ubrialia, Ubriali. Aty është rruga
23 kryesore që lidh me Prishtinën. A mund vjen tani. Mas atijna
24 vjen fshati, Makovc edhe lidhet me Prishtinën. Kur jom dalë në
25 qatë rrugë, aty ka pasë me mijëra, mijëra refugjatë tu shku

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në kundërpjetje nga Z. Von Bone
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Page 44

1 për Prishtinë.

2 Py. [Përkthim] Faleminderit shumë. Tani dua të kalojmë në
3 seancë private.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
5 mund të kalojmë në seancë private të lutem?

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të Nderuar, jemi në
7 seancë private.

8 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit shumë.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Do të flas [REDAKTUAR], dhe për
12 vizitën në familjen e tij.

13 Py. Z. Dëshmitar, nga sa the ti kuptova se [REDAKTUAR] mbeti
14 pas. Ishte ende tek ai vendi, nga ku u lirove ti, kurse ti u
15 nise në drejtim të Prishtinës. Më duket se the, e ke thënë
16 edhe në deklaratë, se në fakt shkove për [REDAKTUAR].

17 Pë. Po.

18 Py. Ku banonte [REDAKTUAR] e tij?

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03593 (Vazhdim) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në kundërpjetje nga Z. Von Bone Page 45
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Von Bone, bëj një pyetje të hapur se tre herë ke bërë një

3 pyetje të mbyllur, ia ke përcaktuar.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Pa dashje më shpëtoi. E kuptoj,

5 faleminderit.

6 Py. Pra e kam të drejtë kur them se shkove për [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR].

8 Pë. Po.

9 Py. Më thua të lutem.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Prapë

11 e bërë. E përsërite. Mund t'i thuash kë shkove të vizitosh?

12 Kujt i bërë vizitë?

13 Pë. Po me thonë të drejtën, [REDAKTUAR], se unë e kom

14 mendue, dhe ai kolegi jem që u konë me mu, jena konë të uritun

15 shumë që s'kena mujt as me ec rrugës [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 Py. E kuptoj. Ti i the [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 Pë. Po, se unë e kom mendu që ka me u liru.

24 Py. [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]?

- 1 Pë. Jo, jo, jo, jo. Normal me kon me fol, asnji fjalë s'kom
2 pasë nevojë [me i thonë] [REDAKTUAR].
3 Py. Pse nuk i tregove? Çfarë problemi kishte t'i tregoje?
4 Pë. Çfarë problemi kom pasë [REDAKTUAR]?! Se kom pasë të
5 domosdoshme [REDAKTUAR]
6 [REDAKTUAR]
7 [REDAKTUAR]
8 [REDAKTUAR]
9 [REDAKTUAR]
10 Py. Pra, nuk i tregove asgjë për ty, se çfarë të kishte ndodh
11 ty, për të rrahurat, për arrestimin?
12 Pë. Jo, jo.
13 Py. Pse nuk i tregove?
14 Pë. Se s'deshta me i tregue. Se kom pasë, pa qarre me
15 [REDAKTUAR]. S'kom pasë nevojë.
16 Py. Po [REDAKTUAR]?
17 Pë. Po, normal, ishte. Po ai pak paramendojke se që tash vjen,
18 që tash, që tash, që tash, që tash, një orë e gjys ne kena
19 ndejt aty, [REDAKTUAR].
20 Py. [REDAKTUAR]
21 Pë. Jo, zotëri se po të them një herë që s'kena hi në atë
22 bisedë hiç. S'kena pasë nevojë. [REDAKTUAR], normal, po
23 mendoj, [REDAKTUAR]. Ma shumë s'më ka vet asnji
24 fjalë, [REDAKTUAR]
25 [REDAKTUAR] Kurrëgjja tjetër.

1 Py. Po [REDAKTUAR]? As ai nuk tha gjë?

2 Pë. Jo, jo, jo. Jo bre se jena konë të lodhun or ti zotëri,
3 jena konë të lodhun na. Na kena pasë nevojë me ngrënë bukë e
4 atë bisedë se kena ba absolut hiç.

5 Py. N.q.s. mund të pyes për çfarë folët? [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR] Nuk

7 thatë asgjë?

8 Pë. Jo. Kena fol "Çka po ban?", "Qysh je?", "A je mirë?",
9 "Zoti të dhashtë bereqet!", "Falemnders!" Kena honger bukë më
10 shumë. Biles nuk mujt me ditë une shka kom fol, ka kom shkue,
11 kur se di njeri. Në lidhje me qëtë punë që po më vet ti, nuk
12 kena fol hiç kurrëgjja.

13 Py. Po nuk shihej nga pamja jua j se s'ishit mirë, [REDAKTUAR]
14 [REDAKTUAR].

15 [REDAKTUAR] Pra, kishe pësuar

16 lëndime. A nuk dukeshin këto?

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR] Jena konë po të them këmbët

21 s'na kanë mbajt me shku [REDAKTUAR].

22 Py. Po në Prishtinë ku shkove?

23 Pë. Në Prishtinë kom shkue, jom shoqëru [REDAKTUAR].

24 Jena shkue [REDAKTUAR]. Kom ndejt hiç më tepër

25 se 15 minuta. [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në kundërpjetje nga Z. Von Bone Faqe 48
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 Py. Familjes a i tregove çka të kishte ndodh?

5 Pë. Po, normal, çdo njëri i tregon familjes çka ka ndodh.

6 Py. Pak ndenje tek vendi i, tek [REDAKTUAR]. Po

7 [REDAKTUAR]

8 Pë. Kurrkond se kom pa aty, vetëm ky u konë. [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR], s'di.

10 Py. Po pse shkut tek [REDAKTUAR]? Me

11 ç'qëllim vajtët aty?

12 Pë. S'kuptova.

13 Py. Në fillim vajtët tek [REDAKTUAR], tek njerëzit e

14 [REDAKTUAR]. Për ç'arsye vajtët tek njerëzit [REDAKTUAR]?

15 Pë. Po shkum...Po më duket e tregova një herë unë, s'po duhet

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR].

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Kështu e dëgjova edhe unë që tha.

20 Z. VON BONE:

21 Py. Z. Dëshmitar, prej, më fal, [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR], erdhi një moment dhe [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]. Kur u ktheve pastaj [REDAKTUAR]?

24 Pë. Nuk e di, mas nja një muji a tri javë se hala ka pasë

25 ofensivë. Nuk kena guxu me dalë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në kundërpjetje nga Z. Von Bone Page 49
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Py. Po pas lufte, pas luftës, mbasi mbaroi lufta a shkove
2 ndonjëherë në polici apo në ndonjë shoqatë humanitare për
3 t'jua shpjeguar këtë histori, këtë çka të kishte ndodh?
4 Pë. Nuk kam shku kurrkund hiç.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
6 Avokat, koha që të kishim caktuar ka mbaruar. Sigurisht mund
7 të vazhdoni, por thjesht dua të më tregoni pa ju ngutur shumë,
8 sepse e di që keni nevojë t'i bëni pyetje avokatit.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Kemi dhe nja dy gjëra për të
10 cekur mbase 15 deri në 20 minuta maksimum.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Atëherë shumë mirë. Pyetja tjetër është që: Mund të kthehemi
13 në seancë publike apo jo, pyetjet që po i bëni z. Dëshmitar?

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Po sapo fillova njëren temë tani
15 për të vazhduar.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 privat.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Privatisht. Po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
20 përgjithësi për hir të procesverbalit dua të përmend këtu që
21 Zyra Administrative është e pranishme prej orës 11.43 minuta,
22 thjesht për procesverbalin.

23 Mund të vazhdoni.

24 Z. VON BONE:

25 Py. Z. Dëshmitar, para se të vinit këtu, këtu në këtë Gjykatë,

1 në Gjykatën Speciale të Kosovës, dëgjova që Prokurori të bëri
2 nja dy pyetje se të kishte thirrë dikush, [REDAKTUAR]
3 [REDAKTUAR]. Dhe se këtë person
4 e quajnë [REDAKTUAR]. Ky po e thotë [REDAKTUAR] - po nuk e di,
5 [REDAKTUAR]. A është e saktë? [REDAKTUAR]
6 [REDAKTUAR]
7 [REDAKTUAR]
8 [REDAKTUAR]
9 Py. Çfarë të tha ai në të vërtetë? Çfarë tha tamam tamam? Për
10 çfarë fole?
11 Pë. Jena përshëndet normal me atë, edhe po më thërret: "A të
12 kanë thirrë në Gjykatë ndonjiherë?" I thashë: "Jo."
13 Ai tha: "Të kam shok, të kam mik, të kam jaran, në më
14 nigjofsh mue edhe nëse të thirrin mos shko në Gjykatë, se unë
15 mendoj që kanë me të vra!" Kurrëgjja tjetër.
16 Py. Po a nuk e pyete ti atë pse ti tha këto fjalë?
17 Pë. Jo.
18 [REDAKTUAR]
19 [REDAKTUAR]
20 [REDAKTUAR]
21 [REDAKTUAR]
22 Py. Kur ky njeriu, personi të tha: "Mos shko", a të tha dhe
23 ndonjë gjë tjetër?
24 Pë. Jo, jo, se krejt 3 minuta, 5 minuta kena bisedu, ma shumë
25 hiç.

- 1 Py. Ky [REDAKTUAR] - çfarë di ti ndonjë gjë për jetën e tij
2 d.m.th. për këtë [REDAKTUAR], çfarë di?
3 Pë. Se kuptova.
4 Py. Njiheni nga puna, keni punu bashkë, si? Çfarë lloj
5 marrëdhënie tjetër keni?
6 Pë. [REDAKTUAR]
7 [REDAKTUAR]
8 [REDAKTUAR]
9 [REDAKTUAR]
10 Py. Nuk është se tu duk se po të kërcënonte ai?
11 Pë. Jo, jo, jo, jo.
12 Py. Ky [REDAKTUAR] kishte ky ndonjë lidhje me të akuzuarin?
13 Pë. Po, se edhe ka qenë në luftë.
14 Py. Ka qenë në luftë si? Si ka qenë në luftë ai e di?
15 Pë. Thashë, edhe ky ka qenë.
16 Py. Nga e di ti?
17 Pë. Po e di se unë e kom pa me sytë e mij
18 Py. Ku e ke pa?
19 Pë. [REDAKTUAR]
20 [REDAKTUAR]
21 Py. Kur? Kur ka ardhë ky? Kur e ke parë ti në Zllash?
22 Pë. Po që atë ditë që jam shkue, të nesërmen menjëherë. Edhe
23 të nesërmen a të pasnesërmen, nuk jam i sigurt, veç e kam pa
24 si person. Ka ardh a hy në derë, kur më ka pa mu u çudit. "Si
25 të kanë pru ty këtu a?" [Thashë] "Nuk di valla." Kaq. S'më ka

1 thonë kurrëgj tjetër.

2 Py. Po ç'punë kishte ai aty? E di ti? Pse kishte ardhë ai aty?

3 Pë. Ku di unë more burrë se s'jom konë aty udhëheqësi i tyne?!

4 Ku e di unë? Jom kenë mrena në arrë kom ndejt. Ku e di unë çka

5 osht ai, çka ban ai, çka mbaron ai, nuk e di.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Një moment të nderuar Gjykatës.

7 [Avokati i Mbrojtjes këshillohet]

8 Z. VON BONE: [Përkthim]

9 Py. Është hera e parë që po na thua që [REDAKTUAR] ka qenë në

10 Zllash apo e ke thënë dhe herë tjetër më përpara për këtë gjë?

11 Pë. Po s'di e kom thonë që tash, a kom thonë që tash, nuk e

12 di.

13 Py. The që [REDAKTUAR]. Po kur e pe aty në Zllash a u

14 frikësive prej tij në ndonjë mënyrë? A mujte me u friksu prej

15 tij?

16 Pë. Jo, [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR] Edhe mbasi më ka takue, po të them drejtë, edhe me

18 siguri diçka edhe më ka ndihmu. Sa më ka ndihmu nuk e di.

19 Py. Si të ka ndihmu?

20 Pë. Po me thonë të drejtë pastaj, që atë rrehjen që kom hongër

21 unë ma herët -- ndoshta i ka fol dikujt unë nuk e di - që nuk

22 e meritoj me ma bo ashtu se s'jam qasi personi - nuk e di ça

23 ka folë. Nuk di ça ka thonë.

24 Py. Po si, nga e di të që të ndihmoi? Në ç'mënyrë të ka

25 ndihmu? Me ç'mënyrë të ka ndihmu?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në kundërpjetje nga Z. Von Bone Page 53
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. O burrë, unë po mendoj që ashtu, se nuk e di unë. Po
2 paramendoj. Nuk e di.

3 Py. Faleminderit shumë.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Të Nderuar Gjykatës mund të
5 kalojmë në seancë publike.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit.

8 Të kalojmë në seancë publike znj. Sekretare.

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të Nderuar Gjykatës
11 jemi rikthyer në seancë publike.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Avokat, keni fjalën.

15 Z. VON BONE: [Përkthim]

16 Py. Z. Dëshmitar, ca pyetje të fundit na kanë mbetur. Keni
17 kërkuar kompensim; një farë kompensimi, dëmshpërblimi. A keni
18 kërkuar dhe në vend tjetër kompensim për lëndimet që të janë
19 bo?

20 Pë. Jo, se nuk di vend tjetër që ka pas qetu ku kom kërku që
21 tash te zonja avokatja jeme.

22 Py. Po edhe në Kosovë nga ana ligjore ekziston mundësia. Pse
23 s'ke kërku ndonjë mundësi me e kërku këtë gjë?

24 Pë. Nuk më ka interesu. S'më ka interesu. As mujt me lyp.

25 Është një vend.

1 Py. Po ky vend i vetëm mund të ishte Kosova. Pse nuk t'u duk
2 mirë apo nuk të ka interesu me e kërku këtë kompensim në
3 Kosovë gjatë gjithë këtyre viteve?

4 Pë. Me thonë të drejtën s'më ka interesu, se tyben e kom ditë.

5 Py. Po ndihmë, nuk mund të kërkoje me e gjetur këtë në Kosovë?

6 Pë. Jo valla s'kom kërku hiç. As më ka interesu.

7 Py. Po pse po të intereson befaz tani? Se këtu ke kërku
8 kompensim. Mund të shpjegosh pse befaz po të intereson?

9 Pë. Mue ma së tepërmi, zotni, më intereson për kompensim, ma
10 së tepërmi, se jam i lëndum, [REDAKTUAR]. E këto

11 të tjerat mu absolut s'më interesojnë. Unë nuk jam gjykatës,
12 as u kom hetues, as me dënu dikënd, apo mos me dënu dikënd. Po
13 se unë jom ardhë ma tepër për kompensim, kam nevojë. Kurrsgja
14 tjetër.

15 Py. Sa kompensim kërkon?

16 Pë. Unë nuk e di, nuk jam gjyqtar. Sa më takon a s'më takon
17 nuk e di. Çka më takon ato, të drejtën që në paça. Në mos e
18 paça kurrsgja kurrkujt.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

20 Avokat, shoh Mbrojtësja e Viktimave është ngritur në këmbë.

21 ZNJ. PUES: [Përkthim] Po, faleminderit.

22 Dua t'i rikujtoj Avokatit të Mbrojtjes që në pyetjet e
23 tij, ai duhet të përqendrohet tek sqarimi i së vërtetës e
24 pastaj nëse dikush kërkon që të ushtrojë të drejtat e njeriut
25 dhe të drejtën për dëmshpërblim, janë pyetje të cilat për mua

1 janë të pakuptimta, pa lidhje këtu. Po kështu edhe pyetja sa
2 kompensim, çfarë shume mund të kërkojë dëshmitari --
3 dëshmitari nuk mund t'i japë përgjigje këtyre lloj pyetjeve.

4 Është Gjykata vetë ajo që ua kërkon mendimin ekspertëve,
5 tre ekspertë të ndryshëm në fakt për sa u takon pyetjeve të
6 lidhura me zhdëmtimin. Prandaj në këtë rast, me këtë
7 Dëshmitar, këtë pyetje janë të atilla që nuk mund të marrim
8 përgjigje të duhura, të përshtatshme nga dëshmitari sipas
9 mendimit tim.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit.

12 Z. Avokat, pyetjet u bënë. Dëshmitari përgjigjen e dha.
13 Unë nuk do të...

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Kam një pyetje të fundit. Nuk
15 është për punë shume.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Vazhdoni. Të shohim.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Në ç'mënyrë pret ndonjë
19 kompensim?

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Avokat i Mbrojtjes, ku po doni të dilni me këtë pyetje?

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua të di çfarë pret Dëshmitari?
23 Sa i takon dëmshpërblimit, kompensimit. Mos po kërkon
24 kompensim.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mos

1 po e pyesni se çfarë kompensimi pret? Sa e do kompensimin?

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, po e pyes, mos e do në pare a
3 në ndonjë mënyrë tjetër që mund të kontribuoj për t'ja
4 zhdëmtuar lëndimin, dëmet a ku di unë, diçka. Gjithçka që mund
5 ta ndihmojë e mund t'i vyejë në çdo lloj mënyre. Pra pa u
6 përqendruar tek paraja apo ku di unë tjetër. Çfarë pret
7 zotëria? Çfarë shpreson?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe
9 unë desha ta kisha të qartë këtë pyetje. Pra mund ta shpjegoni
10 më shumë këtë gjë.

11 Po, po, e pashë, e pashë. E pashë me cep të syrit që
12 ishit të ngritur më këmbë. Ju lutem keni fjalën.

13 ZNJ. PUES: [Përkthim] Shumë shkurt për t'ju rikthyer
14 rregullës 143, në paragrafin 3, është një dispozitë e qartë që
15 pyetjet që i bën Mbrojtja, pala kundërshtuese, duhet që të
16 kenë lidhje vetëm me çështjet që kanë të bëjnë me
17 kredibilitetin, besueshmërinë e dëshmitarit. Unë nuk e kuptoj
18 këto lloj pyetjesh për llojin e zhdëmtimit që ju kërkoni të
19 bëni. Në fakt është një çështje shumë e vështirë, sepse
20 zhdëmtimet janë ende në zhvillim në fushën e së drejtës.
21 Prandaj dhe unë e citova rregullën që sapa citova.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
23 këtë pikë do t'ia jap fjalën edhe Zyrës së Prokurorit se është
24 diçka për të cilën vërtetë na duhet të marrim mendim.

25 Ju lutem, z. Prokuror.

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo është,
2 janë kundërpyetjet që bën Avokati Mbrojtës. Pra pyetjet që i
3 bën dëshmitarit të palës tjetër. Besojmë se Avokatit i duhet
4 lejuar që të eksplorojë, të këqyrë të gjitha çështjet dhe
5 pikat që kanë të bëjnë me kredibilitetin e dëshmitarit. Po
6 mbase Avokati mund të shpjegojë sesi lidhet kjo pyetje me
7 besueshmërinë e dëshmitarit. Dhe nëse e bind Trupin Gjykues që
8 këto pyetje kanë të bëjnë vërtetë me thelbin e besueshmërisë
9 së dëshmitarit, duhet lejuar që t'i bëjë këtë pyetje, sepse
10 është - pikërisht kjo është hapësira që lejon dhe Trupi
11 Gjykues sa i takon kundërpyetjeve, çfarë lejohet, çfarë nuk
12 lejohet. Në fakt kjo do të ndikojë më pas edhe në tagrin që do
13 t'i jepet Prokurorisë për të bërë ripyetje.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua
15 t'i them diçka dëshmitarit z. Prokuror.

16 Z. Dëshmitar, hiqi dëgjueset të lutem. Faleminderit.

17 Më falni që ju ndërpreva, po më mirë kështu.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ajo që unë sapo thashë,
19 qëndron. Ne besojmë që nëse këto pyetje kanë të bëjnë me
20 besueshmërinë e dëshmitarit, i duhet lejuar avokatit t'i bëjë
21 këtë pyetje. Por mbase do të ishte mirë që z. Von Bone të
22 shpjegojë diçka më shumë nëse janë me lidhje apo jo. Mund të
23 jenë me lidhje, por i duhet dhënë mundësia që të shpjegojë.
24 Siç e thashë më përpara duhet të kemi rregulla të barabarta
25 loje, sepse mbase më vonë edhe Prokuroria mund të ndodhet në

1 një situatë të ngjashme kur bëhet fjalë për besueshmërinë e
2 dëshmitarëve të Mbrojtjes. Duhet të kemi caqe të qarta për
3 këtë.

4 Mbase Avokati duhet të sqarojë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
6 do të dëgjoj parashtrimet e të gjithëve, për të parë nëse ka
7 ndonjë gjë të re për të shtuar.

8 Pashë një lëvizje dhe në anën time të djathtë. Po ju jeni
9 në rregull. Pra e keni mjaftuar në komentet tuaja.

10 Z. von Bone.

11 Sa i takon besueshmërisë, mund të thoni diçka për këtë?

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Të flas njëherë dëshiroj për
13 gjërat që dëshiroj të shpjegoj. Zyra e Prokurorit të
14 Specializuar sigurisht ka bërë pyetje për shëndetin e
15 personit, çfarë lloj lëndimesh ka pasur. Dhe sigurisht edhe
16 kjo pjesë ku ai kërkon dëmshpërblim është një çështje e cila
17 do të trajtohet gjatë këtij procesi gjyqësor nga Mbrojtja.

18 Nëse ne nuk jemi në gjendje t'i bëjmë pyetje dëshmitarit,
19 kjo s'ka të bëjë fare me faktin se unë dua të di sesa apo jo.
20 Po ka të bëjë me llojin e dëmshpërblimit që kërkon në veçanti
21 - dhe për çfarë, për lëndimin në kokë, apo për aspektet
22 mendore. Siç e thashë më herët, e ceka, d.m.th. e pashë pse
23 nuk e kishte kërkuar vetë në Kosovë.

24 Sa i takon besueshmërisë - besueshmëria ka të bëjë edhe
25 me atë nëse dikush një lloj kompensimi për diçka. Do të doja

1 që ta testoj paksë nëse ka të bëjë në fakt me çështjet,
2 aspektet, me të cilat ne kemi të bëjmë gjatë Mbrojtjes. Lidhur
3 me këtë mendoj unë, mund të jetë pjesë e besueshmërisë për atë
4 aspekt.

5 Nuk mund të kemi një çështje gjyqësore, ku mund të themi:
6 "Që këto janë, ky është dokumenti mjekësor i dikujt. Ka pësuar
7 këto pasoja" dhe pastaj më pastaj nuk na lejohej apo nuk na
8 jepet mundësia të bëjmë pyetje qoftë edhe për aspektin e
9 kompensimit.

10 Po kështu, në mënyrë të barabartë, ju mund të bëni të
11 njëjtën gjë për dëshmitarët e Mbrojtjes.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Ka një çështje këtu në lidhje me dëshmitarin.

15 Do t'i japim leje dëshmitarit të dalë nga salla një
16 moment.

17 [Dëshmitari largohet nga salla]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
19 tua jap fjalën juve, por dua që t'i kërkoj edhe Prokurorisë që
20 të japë mendimin e vet lidhur me argumentin e ngritur nga
21 Avokati Mbrojtës, që s'ka të bëjë vetëm me besueshmërinë që
22 bëjnë pyetjet, por edhe në përgjithësi, nëse po i bëj një
23 përmbledhje të saktë të asaj që thatë ju z. Von Bone, lidhur
24 me dëshpërblimin, sepse mund të jetë problem që do të ceket
25 në këtë proces gjyqësor.

1 Fillimisht fjalën Prokurorisë, pastaj do t'ju drejtohem juve.

2 Mund të jepni dhe ju komentet tuaja lidhur me këtë.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kemi dy
4 problem këtu. Së pari është besueshmëria dhe ju besoni se në
5 përputhje me rregulloren dhe me praktikën e shumë gjykatave në
6 mbarë botën, kundërpyetjet -- flas për sistemet ku lejohen
7 kundërpyetjet, duhet ofruar më shumë hapësirë për të
8 eksploruar besueshmërinë sepse një prej qëllimeve të
9 kundërpyetjeve është që të kundërshtohet, prapësohet
10 besueshmëria e dëshmitarit të palës tjetër. Ky është qëllimi.

11 Por, problemi tjetër janë kundërpyetjet në përgjithësi si
12 proces - varet nga vendi në vend. Në shumë juridiksione që
13 kanë procese ballafaqese, kundërpyetjet janë më solide, dhe
14 gjykatësi i jep palës që bën kundërpyetje më shumë hapësirë
15 për të bërë edhe disa pyetje të tjera, sepse avokatit duhet
16 t'i jepet hapësirë, më shumë mundësi që të kundërshtojë
17 dëshmitarin dhe historinë e dëshmitarit.

18 Se s'është vetëm besueshmëria, është edhe
19 njëtrajtshmëria, përputhshmëria e atyre që thotë. Por edhe në
20 kontekstin më të gjerë, unë e ceka këtë më përpara kur mu dha
21 fjala. Do të vijë një moment kur edhe Prokuroria do t'u bëjë
22 pyetje dëshmitarëve që thërret këtu Mbrojtja dhe mendoj se
23 është një diskutim që ia vlen të bëhet për të parë sesa
24 hapësirë duhet lejuar në kundërpyetje, p.sh. nëse lejohen apo
25 jo pyetjet orientuese. Në disa juridiksione, edhe në

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 kundërpyetje, pyetjet orientuese lejohen. Madje në disa të
2 tjera lejohen vetëm pyetjet e hapura.

3 Është hera e parë faktikisht që hasim në një situatë të
4 tillë. Mbase ju mund të shqyrtoni më shumë për këtë, mund të
5 bëni një diskutim, mund të dilni me një vendim mbase në letër,
6 apo të thënë gojarisht në seancën e ardhshme. Edhe ne mund ta
7 diskutojmë bashkë me palën mbrojtëse, dhe t'ju paraqitemi me
8 një qëndrim më të gjithanshëm. Dhe flas për kundërpyetjet në
9 përgjithësi, çfarë duhet bërë dhe çfarë lejohet.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit për komentet.

12 Avokati i Viktimave, keni fjalën.

13 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit shumë.

14 Duhet të bëjmë dallim midis dy gjërave. E para është
15 gjyqi penal, ku ne kemi për detyrë të vërtetojmë fakte të
16 caktuara që kanë ndodhur. Dhe për këtë ky dëshmitar ka ardhur
17 këtu dhe duhet të dëshmojë, duhet të shpjegojë ato që mban
18 mend, nga ato që ka përjetuar dhe ato fakte që i kujtohen. Dhe
19 këtë duhet të testojmë këtu, në këto pyetje që i bëhen nga
20 pala tjetër apo çfarë palët e ndryshme duhet të testojë.

21 Çështja e pasojave ligjore, juridike është çështje
22 tjetër. Dhe pasojat mund të jenë të ndryshme lidhur me faktet
23 që ne në fund të gjykimit do të provojmë. Dhe ju sigurisht
24 kërkohet të vendosin. Këto pasoja kryesore mund të jenë një
25 dënim, një ndëshkim. A mund ta pyesim në këtë rast dëshmitarin

1 sesa, për sa kohë do ti që i akuzuari të shkojë në burg? Nuk
2 është një pyetje që, për mendimin tim është një pyetje që
3 Mbrojtja apo dikush tjetër mund të donte ta bënte. Dhe nuk
4 ndihmon në gjetjen e të vërtetës.

5 E njëjta gjë mund të thuhet për mendimin tim, edhe në
6 rastin e kompensimit që dikush pret të marrë, sepse është
7 çështje e reparacioneve si çështje. Është një pasojë tjetër që
8 mund të burojë, mund të rrjedhë nga faktet vërtetuara. Dhe
9 këtë po bëjmë këtu për momentin.

10 Pyetja e dytë, në lidhje me pasojat ligjore apo juridike,
11 lidhur me reparacionet apo dëmshpërblimet është diçka që ne si
12 avokatë të gjithë mund ta bëjmë. Duhet të mendojmë përgjatë dy
13 linjave mendimi. Një është, që në fund, kompensimi apo
14 dëmshpërblimi i pretenduar ka një natyrë të ndryshme. Dhe
15 është një territor i pashkelur sepse është rast i parë që
16 trajtohet përpara KSC-së. Gjykatat e tjera mund ta kenë bërë
17 ndryshe. Gjykata Penale Ndërkombëtare për shembull i ndan
18 procedurat e dëmshpërblimeve.

19 Kurse ne nuk e bëjmë këtu. Megjithatë, kjo nuk do të
20 thotë se kjo është ajo çështja e duhur që duhet diskutuar me
21 dikë që nuk ka pasur ende mundësi të marrë konsultime ligjore
22 për këtë çështje apo këshilla të plota ligjore. Mbase duhet
23 edhe të bëjmë redakte, sepse dëshmitari mbase mund të jetë
24 një nga ata që marrin pjesë apo jo?

25 Është diçka për të cilën duhet menduar. Diçka në fakt që

1 mund të diskutohet në mënyrë abstrakte.

2 Çdo viktimë që merr pjesë në një proces gjyqësor mund të
3 kërkojë dëmshpërblime dhe ne e kemi bërë të qartë, që kështu
4 ndodh. Vetëm me kalimin e kohës mund të kuptohet natyra e
5 plotë dhe mundësia, mundësitë që ekzistojnë. Për shembull,
6 raportet e ekspertëve duhen dëgjuar dhe vetëm atëherë në fund
7 pastaj mund të jepet këshillë ligjore për ta informuar
8 viktimën që merr pjesë për të krijuar një ide. Dhe vetëm
9 atëherë, mund të kemi një bazë të fortë ku mund të
10 mbështetemi. Kurse tani, në këtë çast do të ishte e
11 parakohshme të diskutohej me këtë dëshmitar. Prandaj mendoj që
12 në asnjë rrethanë kjo nuk është çështje që duhet bërë në kohën
13 e marrjes në pyetje të dëshmitarit.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua të kërkoj fjalën për të
15 diskutuar një çështje lidhur me këtë temë. Por mendoj që është
16 më mirë ta bëjmë në seancë private.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Avokat i Mbrojtjes, do t'ju drejtohesha. Nuk të harroj sepse
19 këtu jemi të gjithë të pranishëm, të gjithë palët, të gjitha
20 palët.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta
22 jap tani fjalën.

23 Punonjëse e gjykatës, të lutem a mund të na futësh në
24 seancë private?

25 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Avokat ke fjalën.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Çështja e fundit që doja të
5 diskutoja dhe po e bëj në seancë private është - kemi
6 dokumente që kanë të bëjnë me shëndetin e tij, pra dokumente
7 mjekësore që i kemi, tek të cilët duhet të mbështetemi. N.q.s.
8 dikush thotë, [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR] çfarë do të kishte një dokument i tillë, n.q.s.
10 nuk mund të ngremë asnjë çështje? Dhe unë e preka shumë pak në
11 fakt të gjithë këtë çështje. Por do të thosha se mund të
12 lidhet me kredibilitetin e një dëshmitari lidhur me një
13 çështje.

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR] po megjithatë lidhet me besueshmërinë
17 e tij dhe me formën e kompensimit që ai mund të kërkojë për
18 një lloj lëndimi të pësuar. Është një çështje që ka të bëjë me
19 kredibilitetin nga njëra anë, të cilin unë në fakt nuk e kam
20 prekur pothuajse. Por dua të mësoj diçka kur dikush kërkon një
21 kompensim. Çfarë kompensimi është ai? Nuk po e pyes për gjëra
22 ligjore, apo për shuma, apo gjëra të tilla. Thjesht nëse mund
23 të na thotë. Mbase do të ishte në përfitim për të gjithë
24 procesin.

25 Këtë desha ta pyesja lidhur me këtë çështje. Nuk e kam

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 prekur, nuk do ta prek, por në një moment këto gjëra,
2 sigurisht mund të trajtohen. Dhe jo sepse bëhet fjalë për një
3 person që kërkon kompensim apo që ka status të dyfishtë. Për
4 këtë s'do të bëja pyetje.

5 N.q.s. Prokuroria do të bënte pyetje të tilla, do të
6 ishin me dobi.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
8 bëtë të qartë. E kam të qartë atë që kërkonti të bëni.

9 [Trupi Gjykes dhe Sekretarja e Gjykatës
10 këshillohen]

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Avokate e Viktimave, e shoh që jeni ngritur prapë.

13 ZNJ. PUES: [Përkthim] Do të flas shkurt.

14 Pikërisht kjo pika e fundit konfirmon atë që thashë më
15 herët. N.q.s. keni dyshime për [REDAKTUAR] që ka
16 pësuar ky dëshmitar, pyeteni për këtë gjë, testoheni
17 besueshmërinë e tij. Këto janë fakte që duhet të provojmë. Dhe
18 këtu do të bëjmë dallimin. Por kjo është një pyetje e ndryshme
19 nga pyetja që i bëhet për kompensimin në vetvete.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit.

22 Z. Prokuror, mund të flisni.

23 Z. Whiting: [Përkthim] Nëse më lejoni - Më vjen keq që
24 ndërhyj, por meqenëse ka të bëjë me politikën e zyrës dua ta
25 trajtoj shkurtimisht. Dua të jem i qartë se kemi mendime pak

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 të ndryshme nga Avokatja e Viktimave. Mendimi ynë është se ka
2 mundësi të eksplorohen çështje të besueshmërisë lidhur me
3 çështjen e kompensimit apo përfitimeve.

4 Megjithatë, mendoj se, do të ishte në të mirën e procesit
5 për në drejtësinë e tij, n.q.s. bëhet një pyetje e
6 drejtpërdrejtë dhe më konkrete. N.q.s. i bëhet një pyetje e
7 drejtpërdrejtë dëshmitarit, për shembull, nëse motivimi i tij
8 mbështetet në dëshirën për kompensim. Por nuk mendoj se është
9 shumë e drejtë lidhur me dëshmitarin që të vish vërdallë
10 çështjes së kompensimit.

11 Qëndrimi ynë është që ka vend që të bëhen pyetje të
12 tilla. Por duhet t'i bëhen drejtpërdrejt, në mënyrën e duhur
13 dhe t'i jepet mundësia dëshmitarit të thotë nëse është i
14 motivuar - ka ardhur këtu për të dëshmuar në këtë sallë gjyqi
15 për këto akuza. Në këtë rast sepse pret të marrë kompensim. Ky
16 është qëndrimi i zyrës sonë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit Zëvendësprokuror. U paraqitën të gjitha mendimet
19 në mënyrë të mjaftueshme përpara Trupit Gjykses. Ne si Trup
20 Gjykses do të tërhiqemi për të bërë një diskutim të shkurtër,
21 për të parë se ku jemi lidhur me këtë çështje dhe do të
22 kthehemi përsëri. Nuk besoj se do të vonohemi shumë.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë.
24 Ndërpritet për pesë minuta.

25 --- Pauza fillon në orën 12.42.

1 --- Seanca rifillon në orën 13.01.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Sekretare a mund të kalojmë në seancë publike përsëri.

4 [Seancë e hapur]

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë të
6 hapur.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit.

9 Po shoh orën dhe kam një përgjigje për pyetjen konkrete
10 që deshe të bëje, por kemi vendosur që të japim disa udhëzime
11 me gojë. Nuk do të jetë një urdhër. Pas pushimit kemi thënë që
12 në fillim që lidhur me zhvillimin e procedurave, që nuk do të
13 japim një vendim për çdo çështje konkrete. Por siç erdhën
14 punët do të japim disa udhëzime për këtë çështje.

15 Dëshmitari pret jashtë. Po e lëmë aty deri pas pushimit.

16 Lidhur me klientin e Avokatit Mbrojtës - deri tani - kemi
17 një pyetje.

18 Deri tani mirë ka qenë lidhja me të?

19 Po. Pra, çdo gjë ka qenë në rregull.

20 Z. Mustafa, nuk e thashë sot në mëngjes, por po e them
21 tani. Ke të drejtën të mos flasësh. Dhe kjo nuk do të merret
22 parasysh në vendimin tonë. Gjithmonë duhet të ta them përpara
23 se të flasim. Lidhja ka qenë në rregull deri tani, lidhja me
24 video?

25 I AKUZUARI: [Nëpërmjet videolidhjes] Po, shumë e mirë.

1 Shumë e mirë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] [I
3 drejtohet përkthyesit] A mund ta përsërisësh edhe njëherë atë
4 që tha i akuzuari se s'kisha vënë kufjet?

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
6 Mustafa, pra lidhja ka qenë në rregull? A mund t'i ndjekësh në
7 rregull procedurat këtu?

8 I AKUZUARI: [Nëpërmjet videolidhjes] Po, e nderuar
9 Gjykatëse.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ke
11 mundur të konsultohesh edhe me avokatin tënd?

12 I AKUZUARI: [Nëpërmjet videolidhjes] Po, e nderuar
13 Gjykatëse.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
15 rregull. Sa për t'u siguruar që mund t'i ndjekësh procedurat
16 dhe të marrësh pjesë në to në mënyrë efektive.

17 Tani është ora 1.00. Do të bëjmë pushim deri në orën
18 2.30. Pra e ndërpresim punën këtu.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: Të gjithë në këmbë.

20 --- Pushimi i drekës fillon në orën 13.05.

21 --- Seanca rifillon në orën 14.39.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Uluni ju lutem.
23 Mirë se erdhët përsëri të gjithëve.

24 Fillimisht kam diçka të përgjithshme për të diskutuar. Ju
25 lutem palëve dhe mbrojtjes së viktimave, kur të më drejtoheni

1 mua, më falni. Kur të flisni, mu drejtoni mua drejtpërdrejtë
2 dhe jo njëri-tjetrit. Se kështu është më se e përshtatshme.

3 Ju premtova njëfarë udhëzimi sa i takon pyetjes,
4 hapësirës për të bërë pyetje dëshmitarëve për çështje
5 dëmshpërblimi. Ka dy procedura të cilat zhvillohen përpara
6 këtij Trupi Gjykses: pikë së pari është procesi penal sa i
7 takon konstatimit, pra gjetjes së të vërtetës në lidhje me
8 aktakuzën dhe nga ana tjetër kemi edhe procedurën diskutuese
9 për të parë nëse Trupi Gjykses dëshiron apo jo t'i referojë
10 viktimat në gjykatat kosovare. Këtu e kam fjalën për
11 paragrafin 14 dhe 15 të dokumentit 144.

12 Në kundërpjetje, avokati i mbrojtjes në parim mund të
13 bëjë pyetje lidhur me të dyja këto procedura. Sipas rregullës
14 143(3) mund të bëjmë pyetje gjatë kundërpjetjeve lidhur me
15 besueshmërisë së dëshmitarit përfshirë edhe arsyet, pse
16 dëshmitari jep këtë dëshminë.

17 Nuk lejohet të pyetet dëshmitari, përse dëshiron
18 dëmshpërblim. Dëshmitarët që janë edhe viktima pjesëmarrëse në
19 proces, kanë të drejtë për dëmshpërblim sipas kuadrit ligjor
20 të DHSK-së nëse i përmbushin kushtet.

21 Dëshmitarëve mund t'u bëhen pyetje lidhur me motivet apo
22 motivimin e dhënies së dëshmisë, për aq sa kjo prek
23 besueshmërinë e tyre.

24 Mbi të gjitha është e rëndësishme të mos harrojmë se,
25 qëllimi i pyetjeve që i bëhen dëshmitarit duhet të jetë gjetja

1 e fakteve. Pyetje të pranueshme për shembull përfshijnë,
2 llojin e dëmit që pretendohet që ka pësuar dëshmitari si
3 pasojë e krimeve për të cilat ngrihet akuzë, kostot mjekësore
4 që i kanë lindur apo lidhja midis dëmit dhe fakteve të
5 pretenduara në aktakuzën e konfirmuar.

6 Nuk lejohet asnjë pyetje t'i bëhet dëshmitarit që kërkon
7 pikëpamjet e dëshmitarit lidhur me llojin apo sasinë e
8 dëmshpërblimit që kërkon.

9 Objekti apo modalitetet e zhdëmtimit, nëse do të ketë, do
10 të diskutohen vetëm në një fazë të mëvonshme.

11 Atëherë sa i takon pyetjes suaj Avokati i Mbrojtjes. Ju
12 po pyesnit, çfarë lloj -- Pra pyetja juaj ishte kjo: çfarë
13 lloj dëmshpërblimi kërkon. Unë e perifrazova. Këtë pyetje
14 bëtë?

15 Z. VON BONE: Po, e nderuar Gjykatëse, jo përse.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA VELDT-FOGLIA: Jo
17 "përse" por, "sa, çfarë".

18 Z. VON BONE: Po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA VELDT-FOGLIA:
20 Këtë lloj pyetje nuk do ta lejojmë. Kishe pyetje të tjera për
21 dëshmitarin? Me mikrofon ju lutem.

22 Z. VON BONE: Po.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA VELDT-FOGLIA:
24 Përpara se të lejoj hyrjen e dëshmitarit në sallë, do të bëj
25 prezencën, do shikojmë kush është i pranishëm. Shikoj në të

1 djathtë.

2 Z. MICHALCZUK: Nuk ka ndryshime, në përbërjen tonë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA VELDT-FOGLIA: Po
4 e njëjta edhe me Mbrojtësen e Viktimave. Pala e Mbrojtjes
5 është po i njëjti ekip. Z. Mustafa e shoh të pranishëm. Shikoj
6 edhe përfaqësuesin e Zyrës Administrative të pranishëm. Dhe
7 Trupi Gjykes po kështu është i pranishëm i plotë siç ka qenë
8 edhe sot paradite.

9 Zonja ftuese, a mund ta shoqëroni dëshmitarin të hyjë në
10 sallë përsëri? Faleminderit.

11 [Dëshmitari hyn në sallë]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
13 Dëshmitar mirë se erdhe prapë.

14 DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
16 vazhdojmë tani me pyetjet që ka Avokati. Z. Avokat, a mund të
17 na tregoni edhe sa kohë ju duhet ende?

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Mendoj se jo më shumë se sa 10
19 minuta.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,
21 keni fjalën.

22 Z. VON BONE: [Përkthim]

23 Py. Mirëdita z. Dëshmitar.

24 Pë. Mirëdita.

25 Py. Z. Dëshmitar, kam një pyetje lidhur me një dokument

1 mjekësor [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR] Mos

3 duhet për Trupin Gjykues ta lexoj numrin? Është SIFT00296103

4 deri në SIFT00296121, është përkthimi në anglisht dhe

5 dokumenti për të cilën po pyes është dokumenti, është faqja e

6 parë, asgjë tjetër.

7 Z. Dëshmitar, [REDAKTUAR] ke shkuar në një qendër

8 mjekësore. Dokumenti thotë se je [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]. Para 2 javësh ke ndjerë

10 kokëdhembje të vazhdueshme e 2 ditët e fundit plogështi totale

11 të gjymtyrëve. A është e vërtetë që ke shkuar, ke qenë në këtë

12 [REDAKTUAR]?

13 Pë. Po.

14 Py. Dhe ajo që lexova këtu, a është e saktë?

15 Pë. Po me thanë të drejtën mua në atë kohë më ka ardh marre

16 me shku tek mjeku me thanë më ka rreh UÇK-ja. Por kam thanë,

17 jam i sëmurë, çka kam nuk e di.

18 Py. Pse të vinte marre, a e njifje këtë mjek, kishe ndonjë

19 arsye pse të vinte marre?

20 Pë. Po pse, po më vjen marre edhe këtu që po e përmend që më

21 ka rreh UÇK-ja, se leje mo tek mjeku. Nuk ashtë mirë me më

22 rreh. Nuk ka konë mirë. Për këtë arsye.

23 Py. E di që nuk është mirë me u rreh, po njëkohësisht është

24 po aq mirë -- me fal, nuk është mirë me thonë diçka që s'është

25 e vërtetë, me rrejt me një llafe.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po

2 pyetja cila është?

3 Z. VON BONE: [Përkthim]

4 Py. A je dakord, a po pajtohesh me këtë që sapo thashë?

5 Pë. Unë? Jo.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Avokat, kam frikë se nuk e ka kuptuar pyetjen dëshmitari.

8 Z. VON BONE: [Përkthim]

9 Py. Nuk është mirë me e gënjy doktorin, a po pajtohesh me mua
10 që s'është mirë me e gënjy doktorin?

11 Pë. Po.

12 Py. Pra përse ti, një njeri që ishe viktimë që të kishin
13 rraf, po të vinte marre po të vinte turp nga një mjek spitali?

14 Pë. Nuk e di. Ndoshta jam budallë, mua ashtu më ka ardh marre
15 dhe e kam thanë. Se unë s'e kam mësu mjekun -- kam shku tek
16 mjeku, ai më ka bo operacion, ai e din. Se nuk e di unë pse
17 qysh tek. Prej çkave më ka ardh ajo, prej diçkave po.

18 Py. Ke shku prap tek ai mjek, je kon prap tek ai mjek?

19 Pë. Po.

20 Py. Po më vonë më mbrapa, i kallxove se çka të kishte ndodh?

21 Pë. Jo bre burrë, s'i kallxova. S'pata nevojë, ai e ka kry
22 punën e vet. Ai më ka vet, për çka e ke. I thashë, nuk di unë
23 çka kam, unë në këmbë kam ec. Ai më ka bo operacion, ai e din.
24 Unë nuk e di.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

1 Avokat shoh që Prokurori është ngritur në këmbë.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Më vjen shumë keq që po

3 ndërhyj. Është seancë publike siç e dimë ne. Dje Znj.

4 Sekretare na tha që duhet ta fikim mikrofonin pas çdo pyetje.

5 Mbase dhe kolegu i nderuar mund të bëj të njëjtën gjë. Është

6 puna e sigurisë së Dëshmitarit, prandaj dhe po ndërhyjë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit Z. Prokuror që na e vutë në dukje.

9 Z. VON BONE: [Përkthim]

10 Py. Në dokumentin tjetër që është faqja në vijim, është lista

11 e fletëlëshimit, fletëdaljes. SITF 00296104.

12 Z. Dëshmitar, thuhet kështu në këtë dokument, është

13 dokumenti -- mban datën, një datë që s'është krejt e qartë. Po

14 thotë që është marrë asistencë mjekësore nga, [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR] Z.

16 Dëshmitar, në këtë dokument këtu thuhet se, ankesat e tuaja

17 lidhur me atë që [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR] për një periudhë një vjeçare. E saktë, është e

19 saktë kjo që thuhet këtu në këtë dokument?

20 Pë. Po, se unë kam pas probleme [REDAKTUAR] gjithë.

21 Py. Po këto [REDAKTUAR] siç thuhet këtu, a kanë zgjatur për

22 një periudhë një vjeçare, kanë zgjat një vit?

23 Pë. Kanë zgjat ma shumë.

24 Py. Po si ka mundësi që mjeku, apo kush ka shkruajtur këtë,

25 që ka shkruajtur këtu vetëm një periudhë një vjeçare, jo më

1 shumë?

2 Pë. Po atëherë më ka fillu me më [REDAKTUAR], normal.

3 Py. Ka fillu me të dhemb koka më [REDAKTUAR]

4 Pë. Nuk e kam këqyr datën kurrë se s'më ka interesu për

5 datën, më ka dhimt koka. S'e kam pas atë problem me këqyr

6 datat, kur po [REDAKTUAR].

7 Py. Faleminderit.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Duam që të tregojmë dhe një

9 dokument në seancë private, mbase dhe publike megjithatë.

10 Dokumenti siç është paraqitur dhe nuk mund të shikohet nga

11 publiku, nuk e di si funksionon nëse mund të vazhdojmë në

12 seancë publike? Apo të jemi në private. Mund të jemi në

13 publike për sa kohë që dokumentin nuk e sheh publiku.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

15 kuptova.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Numri ERN është 061012 deri

17 061015. Të shikoj edhe nën-ndarje se cila është.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Avokat i Mbrojtjes, Znj. Sekretare më tha se nëse jeni në

20 seancë publike por dokumentin e shfaqim, atëherë nuk mund ta

21 shikojë dot Z. Mustafa këtë dokument. Ah, në të dyja seancat

22 nuk e sheh dot. Po përpiqemi në një mënyrë që ta shikojë edhe

23 klienti juaj dokumentin, po kjo s'është e mundshme. Pajtoheni

24 me këtë?

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, pajtohem. Më duket se

1 nënndarja, me shumë gjasë nënndarja 11 e dosjes së

2 Prokurorisë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jemi

4 në seancë publike, por publiku nuk mund ta shikojë këtë

5 dokument.

6 Z. VON BONE: [Përkthim]

7 Py. Z. Dëshmitar, e shikon atë dokumentin që ke përpara?

8 Pë. Po.

9 Py. Z. Dëshmitar, aty në fund të dokumentit djathtas, a mund

10 të na thuash se çfarë shkruhet aty? Në fund në qoshen e

11 djathtë.

12 Pë. Shkruan, UÇK.

13 Py. Në rregull. Po në anën e majtë?

14 Pë. Në anën e majtë shkruan, policia ushtarake.

15 Py. Në rregull. A mund të na tregosh se përse në anën e

16 djathtë ke shkruajtur "UÇK" dhe në anën e majtë ke shkruar

17 "policia ushtarake".

18 Pë. Qysh me e shkruajt ndryshe, nuk di unë.

19 Py. Më duket se nuk u kuptuam. Po ta shpjegoj pak më mirë.

20 Aty në mes mbi atë vijën horizontale, është shkruajtur diçka.

21 E shikon ti këtë? Ajo vija që ndan faqen.

22 Pë. Po te poshtë, a kështu? Aaa, OK.

23 Py. Çfarë është shkruajtur aty?

24 Pë. Këtu shkruan se, thotë 1 kilometër, dikun 1 kilometër janë

25 konë larg policia ushtarake dhe ushtria e Kosovës.

- 1 Py. Faleminderit shumë. Po në anën e djathë aty lart është
2 shkrujtur një emër, mbi atë rrethin aty ke ana e djathtë ka
3 një emër të shkruajtur. Çfarë është shkruajtur aty?
- 4 Pë. Ashtë emri Fatmir Sopi, ashtë komandant i Ushtrisë
5 Çlirimtare të Kosovës.
- 6 Py. Pse e ke shkruajtur emrin e tij aty?
- 7 Pë. Më kanë pyet kush a konë komandant që të ka -- kush a
8 konë këtu. Tash s'e di pse e kom shkrujt.
- 9 Py. Tek kjo skica këtu, tek ky vizatimi, ka dy anë. Në njërën
10 është UÇK-ja, në njërën është policia ushtarake e shkrujtme?
- 11 Pë. Po.
- 12 Py. Duke përshkruar këtë skicën këtu dhe me këtë distancën
13 prej 1 kilometër, ça ke dash me thanë?
- 14 Pë. Kurrgja. Vetëm më kanë vet sa i ka largësi, sikur ju që
15 po më pyetni, i kam thanë "aty afër 1 kilometër".
- 16 Py. Që është distanca midis policisë ushtarake dhe ushtrisë,
17 UÇK-së. Kështu?
- 18 Pë. Po.
- 19 Py. Në rregull. Ky Fatmir Sopi, ishte komandant i UÇK-së aty?
- 20 Pë. Po.
- 21 Py. Ke qenë ndonjëherë në shtëpinë e tij, ti?
- 22 Pë. Jo, kurrë në jetë.
- 23 Py. Po komandant i policisë ushtarake, a e di kush ka qenë?
- 24 Pë. Po, e di. Ashtë konë klienti yt.
- 25 Py. Mirë. Pra këtë ke dash me shpjegu me këtë vizatimin këtu.

1 E kuptoj. Nuk kam më pyetje për këtë dokument.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Të kontrolloj pak tani me
3 kolegët.

4 Py. Si, nga e ke ditur ti se distanca nga policia ushtarake
5 te UÇK-ja ka qenë 1 kilometër, nga e ke marrë ti këtë
6 informacion?

7 Pë. Po, e kam marrë vesh afërsisht. Se s'e kam mat, se nuk
8 jam asi gjeolog me mat vende.

9 Py. Nuk është ky problemi, pyetja që të bëj unë është kjo:
10 "Nga e ke dit ti që policia nga ushtria ishin të ndame nga
11 njëra-tjetra?".

12 Pë. [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 Py. Po ky informacioni që ke marrë ti, e ke mësuar mbas lufte,
18 gjatë lufte, më fal. Ky informacion, këtë informacion, e ke
19 mësuar mbasi ke dalë nga ajo qendra që të kanë mbajtur, apo
20 gjatë kohës që ishe i ndalum, apo përpara se sa të të ndalonin
21 aty?

22 Pë. Qysh kam mujt zotëri me e dit në luftë që po më fol asi
23 pyetje që po më qet, qysh kam mujt me dalë me mat unë vendin
24 sa kilometra, kur ma herët kam thanë, kam ndejt vetëm mrena i
25 burgos në ahër. Çfarë pyetje po më qet kështu, po më intereson

1 shumë.

2 Py. Atëherë si munde me e bo këtë skicën kur nuk kishe nga ta

3 dije, si arrite ta bësh?

4 Pë. Po unë po foli bre burrë, po ma ka marrë mendja se unë

5 nuk e kam mat. Nuk jam konë ekspert i atyne pyetjeve me këqyr,

6 po veç ma merr mendja që ashtu ka konë.

7 Z. VON BONE: Të nderuar Gjykatës, mendoj që kaq pyetje

8 kishim. Falënderoj Gjykatën, falënderoj Dëshmitarin.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sipas

10 rregullës 127(3) të Rregullores dhe vendimit tonë, mund të

11 lejojmë pyetje shtesë nëse shihet e nevojshme nga palët.

12 Z. Prokuror, dëshiron t'i bësh pyetje të tjera shtesë

13 dëshmitarit? Nëse po, sa kohë do?

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dua të vazhdoj me pyetje

15 shtesë. Do të eksplorojmë më tej dy çështje, të cilat mund të

16 kenë krijuar dyshime të cilat duam t'i sqarojmë. Koha e

17 përgjithshme që do të na duhet për këtë, besoj do jetë 15

18 minuta dhe jo më shumë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit për informacionin. Po informoj se sot do të

21 përpiqemi që të shtojmë edhe një orë sot. I kam kërkuar

22 Njësisë të Mbrojtjes së Dëshmitarëve, që të përfundojmë

23 pyetjet e këtij Dëshmitari sot. Dhe shpresoj se këtë do të

24 mund ta bëjmë.

25 Z. Prokuror keni fjalën.

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit shumë.

2 Pyetje vijuese Z. Michalczuk:

3 Py. Z. Dëshmitar, e di që je i lodhur. Do të të pyes për disa
4 minuta. Përqendrohu të lutem gjatë këtyre minutave tek pyetjet
5 e mia dhe pastaj do të mbarojmë bashkë.

6 Sot, të bënë disa pyetje mbrojtja lidhur me, nëse e ke
7 dëgjuar ndonjëherë të përmendej emri i të akuzuarit kur të
8 mbanin në Zllash. Dhe dua ta sqaroj pak se mbase s'është shumë
9 e qartë.

10 Dua që të të tregoj deklaratën që ke dhënë në [REDAKTUAR]
11 [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] në këtë Gjykatë.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dhe për procesverbal është
13 transkripti i seancës i datës [REDAKTUAR] dhe po ju lexoj
14 një pjesë shumë të shkurtër gjatë pyetjes që i bëra unë
15 dëshmitarit dhe përgjigjes së tij, duke filluar nga rreshti
16 18. Është faqja 54 e transkriptit, rreshti 18.

17 Py. Z. Dëshmitar, më dëgjo me kujdes, do të lexoj fjalët që
18 kemi shkëmbyer të hënën, pyetjet e mija dhe përgjigjen tënde
19 dhe dëgjoje pak. Pyetja e Prokurorit.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dhe për të qenë të qartë, të
21 nderuar Gjykatës, që momenti kur i tregova Dëshmitarit
22 deklaratën e tij dhënë ZPS gjatë procedurës paraprake e datës
23 [REDAKTUAR] pjesa e dytë e rishikuar dhe ne iu referuam
24 faqes 28 të asaj deklarate.

25 Py. Pra tani të kalojmë tek transkripti i të hënës. Prokurori

1 të bëri pyetje dhe unë lexoja nga deklarata jote kur të pyeta.

2 Po e citoj:

3 "Mirë, po ky personi" e kisha fjalën për të akuzuarin,
4 "ishte i njëjti person si herën e parë, herën e dytë, pra ai
5 personi që mbante kapelën e kuqe, apo ishte ndonjë person
6 tjetër".

7 Përgjigja jote ishte, "Po, ai ishte, [REDAKTUAR]. Ai
ishte
8 personi që më vuri revolen pistolën këtu, ai ishte personi".

9 Pastaj Prokurori të pyeti: "Dakord. A ndodhi ndonjëherë
10 në një moment që të dëgjoje ndonjë pjesëtar tjetër të UÇK t'i
11 drejtohej këtij personi me emër e tij apo me ndonjë nofkë,
12 ndonjë emër tjetër?"

13 Përgjigja jote ishte: "Po, e dëgjona njëherë njërin. Mbjaj
14 mend një person që tha një herë, këtu, këtu, këtu [REDAKTUAR].
15 Dhe këtë unë e dëgjova".

16 Dhe pastaj vjen pyetja tjetër që të bën Prokurori: "Por
17 ti e -- edhe unë të pyeta, ti dëgjove dikë që t'i drejtohet
18 Cali".

19 Përgjigja ishte: "Po, kur hyra në dhomë [REDAKTUAR] e
20 pyeti se çfarë të bëj. Dhe unë e dija se ishte [REDAKTUAR]".

21 Pyetja që të bëra të hënën në lidhje me këtë shkëmbim
22 ishte: "A është e vërtetë kjo që ke thënë në atë deklaratë që
23 i ke dhënë prokurorisë në [REDAKTUAR]"?

24 Dhe ti the: "Po".

25 Pyetja që të bëra ishte: "Pra në të vërtetë e dëgjove

1 dikë që tha emrin [REDAKTUAR], është kështu”?

2 Ti the: “Po, kështu është”.

3 Pasi dëgjove të gjitha këto që sapo t’i lexova, e
4 konfirmon përsëri se kur ishe në Zllash në të vërtetë e ke
5 dëgjuar të thuhet emri [REDAKTUAR]?

6 Pë. Po.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam edhe
8 një pjesë tjetër të të njëjtës deklaratë që citova më përpara
9 të datës [REDAKTUAR]. Por kësaj here gjatë seancës o të
10 hënën, o të martën, nuk e përmenda me numër. Por tani dua ta
11 pyes Dëshmitarin, t’ia tregoj, është deklarata që gjendet në
12 faqen 18 të deklaratës, të kësaj deklarate. Është intervista e
13 Dëshmitarit nga Prokuroria në atë ditë në atë kohë. Dhe dua të
14 filloj duke i treguar Dëshmitarit një pjesë të shkurtër. Një
15 pyetje nga Prokuroria dhe një përgjigje të shkurtër.

16 Fillon në faqen 18, në rreshtin 8 dhe vazhdon deri tek
17 rreshti 14.

18 Py. Z. Dëshmitar, përpara Prokurorit ke thënë në [REDAKTUAR]
19 [REDAKTUAR], diçka për pyetjen që të ka bërë. Të ka bërë këtë
20 pyetjen qo do të lexoj:

21 “Më thuaj kur e ke lidhur për herë të parë personin që të
22 rrahu dy herë, në dy raste, me personin me kapelën e kuqe që
23 ti e quan [REDAKTUAR]. Kur e mësove për herë të parë, kur e
24 bëre lidhjen që ky person me këtë emër ishte me emrin
25 [REDAKTUAR]?”

1 Dhe përgjigja jote ishte: "Po unë e dëgjova atë aty kur
2 njëri prej tyre tha, [REDAKTUAR]".

3 E konfirmon këtë që kështu ka qenë që e quajti Cali?

4 Pë. Po.

5 Py. Z. Dëshmitar, nuk dua të thuash asnjë emër tani në këtë
6 çast. Dje, siç të kujtohet, pamë një skicë atë dokumentin që
7 ti e kishe bërë dhe ke vënë një emër aty poshtë. Ta tregoi
8 edhe kolegu im i nderuar të njëjtën skicë dhe ishte ai emri
9 aty. Nuk dua ta thuash emrin, po e pamë të gjithë në ekran pak
10 përpara. Pyetja që kam për ty është kjo: Kur dëgjove emrin e
11 të akuzuarit në Zllash, a ishte kjo një nga arsyet pse ti thua
12 tani që, ai ishte personi që të ka rreh në dy rastet?

13 Pë. Po. Po, po.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
16 shoh që jeni ngritur në këmbë.

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, sepse pyetja kështu si po
18 bëhet, nuk më duket e drejtë. Dhe nuk është me vend të thuash
19 se, ishte emri i të akuzuarit, që ishte në fakt. Pra pyetja që
20 bëri kolegu i nderuar:

21 "Pyetja që kam për ty është kjo, emrin e të akuzuarit në
22 Zllash kur e dëgjove atë, kjo ishte një nga arsyet që ti thua
23 që ai ishte ai që të rrahu?".

24 Ndoshta, të nderuar Gjykatës.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Prit,

1 prit. Do bëj diçka tjetër në fillim. Z. Dëshmitar të lutem
2 hiqi pak ato dëgjueset për momentin se kemi një diskutim.
3 Faleminderit. Vazhdoni.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Po e nderuar.

5 Emri i të akuzuarit po bashkohet me emrin e personit që
6 dëgjoi dëshmitari. Prandaj dhe unë kundërshtoj për këtë
7 pyetje. Nuk është korrekt të thuash që ishte emri i të
8 akuzuarit. Është një emër që ai e dëgjoi që nuk do ta thotë,
9 por nuk është emri i të akuzuarit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
11 Prokuror, a mund ta riformulosh?

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Sigurisht do ta riformuloj.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Prit
14 një çast deri sa Dëshmitari të vendosi përsëri dëgjueset.
15 Ndhimoheni dëshmitarin të vendosi përsëri dëgjueset, ju lutem.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

17 Py. Z. Dëshmitar, më udhëzuan që pyetjen të ta bëj pak
18 ndryshe, prandaj do më lejosh ta bëj përsëri. Pyetja është
19 kjo: Kur dëgjove emrin [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] më herët
20 aty në Zllash, a ishte kjo një nga arsyet që ti po thua se ai
21 ishte personi që të ka rreh në të dy rastet?

22 Pë. Po.

23 Py. Ti the gjithashtu se, mësove se ai personi Cali, ishte
24 përgjegjës aty në Zllash. Tani dua ta dëgjosh pyetjen me
25 kujdes përpara se t'i përgjigjesh. Mendo pak sesi do t'i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje vijuese Z. Michalczuk Faqe 85
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 përgjigjesh. Kur kujton atë kohë lidhur me ato dy të rrahurat
2 që të kanë dhënë aty në Zllash dhe ti ke dëshmuar [REDAKTUAR]
3 për ato edhe [REDAKTUAR]. A pati diçka tek ai personi që të
4 rrahu apo te mënyra si u soll që të bëri ty të mendosh që ai
5 ishte [REDAKTUAR], pse mendove se ishte [REDAKTUAR], çfarë pe
6 ti në sjelljen e tij, në mënyrën si u soll, si të pyeti, që të
7 bëri ty të mendosh që ai ishte [REDAKTUAR]?

8 Pë. Unë me thanë të drejtën s'e kam njoft kush ashtë ai
9 person kështu, por e kam nij herë-herë, i kam nij tuj përmend
10 "[REDAKTUAR]". Edhe në bazë të shenjave, [REDAKTUAR]
11 [REDAKTUAR] edhe teshat, uniformën që ka pas, kam dit që ashtë
12 ai person. Edhe ai person më ka rreh të dytën herë. Ai person
13 i ka [REDAKTUAR], e më ka çu lart atje e
14 më ka rreh me [REDAKTUAR], kom fol edhe këtu.

15 Z. MICHALCZUK: Të nderuar Gjykatës, do ta mbyll këtë
16 çështje dhe do të kaloj tek një tjetër. Por në këtë rast do të
17 doja të hynim në seancë private jo më shumë se 5 minuta.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
19 lutem të kalojmë në seancë private.

20 SEKRETARJA: Jemi në seancë private.

21 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Faleminderit. Vazhdoni z. Prokuror.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

25 Py. Z. Dëshmitar shumë shkurt ka edhe pak pyetje dhe kaq, do

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje vijuese Z. Michalczuk Page 86
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

- 1 të mbarojmë. Dje, mbasi të bëra unë pyetje dhe sot mbasi të
2 pyeti kolegu i nderuar i mbrojtjes, ti fole shkurtimisht për
3 një takim me një person që ti e përmende si [REDAKTUAR]
4 [REDAKTUAR]. Duan të të bëj 2 a 3 pyetje për të gjithë atë
5 situatë dhe për këtë person. [REDAKTUAR]
6 në Zllash në atë kohë, në 1999?
7 Pë. Po.
8 Py. Ti na the që, në një moment ai hyri në haur ku të mbanin
9 dhe ju pyeti, si jeni si po shkoni. E mban mend se si qe
10 veshur atë rast që e ke parë aty?
11 Pë. Po.
12 Py. Si ishte veshur?
13 Pë. Ka pas një -- kapele s'ka pas hiç, por veçse ka pas një
14 jakne të larme të UÇK-së.
15 Py. Mban mend, a kishte ndonjë embleme në uniformë?
16 Pë. Jo, s'kam pa.
17 Py. Dje, por dhe sot kur iu përgjigje pyetjeve të kolegut të
18 nderuar, the që disa njerëz të thanë se ai person Cali, ishte
19 në Zllash dhe se ishte komandant. [REDAKTUAR], mos ishte
20 ndonjë nga këta që të ka thënë ty se Cali ishte komandant në
21 Zllash?
22 Pë. S'e di, s'më kujtohet [REDAKTUAR]
23 [REDAKTUAR]
24 [REDAKTUAR]
25 Nga ka shku, nuk di.

1 Py. E kuptoj. Dhe ti the që, e pashë për shumë pak kohë. Por
2 pyetja ime nuk ka të bëjë vetëm me atë takimin e shkurtër që
3 patet tek hauri. Pyetja ime -- sepse ti na the që ishte ushtar
4 i UÇK-së. [REDAKTUAR], a të ka thënë ndonjëherë, edhe më
5 vonë, ishte një nga personat që të ka thënë se Cali ishte
6 komandant në Zllash?

7 Pë. Po.

8 Py. Një pyetje shumë të përgjithshme tani. Më duket se dje
9 por edhe sot pak me herët, më duket se na the që ke folur me
10 shumë njerëz që të kanë tregu se Cali ka qenë komandat në
11 Zllash. Pak a shumë, sa është numri i këtyre njerëzve, pak a
12 shumë, jo me saktësi, po sa njerëz ta kanë thënë që ka qenë
13 Cali komandant?

14 Pë. Po marrim shembull nja 5 vetë, po marr shembull.

15 Py. Me e kry me këto pyetje për këtë personin [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR] Shumë shkurt të të lexoj se çfarë na the për këtë
19 takim jo më larg se dje.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e kam
21 fjalën për transkriptin e ditës së djeshme 21 shtator 2021,
22 faqe 39, të nderuar Gjykatës. Duhet të fillojmë nga rreshti
23 numër 18 deri në rreshtin 5 në faqen 40. Është një shkëmbim
24 pyetjesh dhe përgjigjesh që bëmë dje për këtë çështje, pa
25 përmendur emra. Pyetja që kam ose më saktë pjesa që lidhet me

1 pyetjen time është kjo, të pyeta atëherë:

2 "A të është afru dikush, a të ka thënë dikush se çfarë do
3 të ndodhë ty nëse vendos të dalësh me dëshmu përpara kësaj
4 Gjykate?"

5 Dhe të thashë: "Mos përmend emra dhe vende, por ma
6 konfirmon, a e pohon që ka ndodhur kjo gjë"?

7 Dhe ti mu përgjigje: "Po".

8 Unë të pyeta pastaj prapë: "Mos ia përmend emrin
9 personit, mos e përmend vendin, por na thuaj se çfarë të tha
10 ai person"?

11 Dhe ti u përgjigje: "Më tha: Po të flas [REDAKTUAR]
12 [REDAKTUAR] Nuk e di a të kanë thirr me dëshmu a jo,
13 ama nëse do më dëgjosh mu, mos shko". Dhe kjo është dhe
14 këshilla që më ka dhënë dhe familja në të vërtetë. Se ai tha,
15 'se po të veprosht kështu, kanë me të myt'".

16 A e pohon, a e konfirmon ky person, se sot na e tregove
17 emrin [REDAKTUAR], të tha që të mos dëshmosh në këtë Gjykatë
18 se përndryshe do të vrasin?

19 Pë. Po zoti Prokuror, ti s'ka pas nevojë. Unë kam fol me ty
20 personal edhe të kam thanë, mos me e shti në procedurë këtë
21 [REDAKTUAR] se kjo ka qenë jashtë krejt. E tash ti mas pari e
22 ke bo këtë të madhe e ke zmadhu. Unë e kam thanë, njeri më ka
23 thonë, se një herë e kam taku në rrugë, më ka thanë,
24 "[REDAKTUAR]"

24 [REDAKTUAR]" . OK, mos me e zmadhu këtë
25 punë me bo, 2 orë po më folni për atë, për atë punë. Vallai

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje vijuese Z. Michalczuk Faqe 89
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 kryt ma çaj, po të kallxoi drejt. Unë s'po di ma qysh me u
2 përgjigj, kryt mu ka ënjët krejt. Nuk po mujt ma juve me ju
3 përgjigj kështu. Edhe me e kom dit që më mbani 3 ditë këtu,
4 kurrë për jetë s'kisha ardh, po them drejtë, para Gjykatës. Po
5 e kam dit veç një ditë. Nuk e kam dit kesi maltrajtimesh, unë
6 nuk jam i akuzuar. Të kam bo kurrëgjë ndoshta, a? Nuk e di. Më
7 lej rehat të shkoj për shp -- të dal se nuk po mujt me jetu
8 ma. Jam i sëmurë, s'po mujt me ndejt. Kryne mo këtë farë pune
9 se. Po më pyetni 10-15 herë një pyetje bre, po kujt ma keni
10 qare more. Se s'po di ma as me mendu s'po muj.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

12 Py. Z. Dëshmitar, do t'i mbaroj, po i mbaroj pyetjet. Edhe
13 një të fundit, a e konfirmon, a e pohon atë që na the dje për
14 këtë takim.

15 DËSHMITARI: S'po mujt me dëgju ma hic. S'po mujt me
16 dëgju, nuk mujt. Nuk mujt me dëgju ma, jam nervoz dhe s'mund
17 me dëgju hiç. Mos fol.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
19 Dëshmitar. Do t'i kërkoj Prokurorit që të mos vazhdojë më.
20 Mendoj se e bëre të qartë, e bëre të qartë.

21 DËSHMITARI: Vallai më paske thirr mua me më çu në spital,
22 s'më paske thirr për diçka. Po bani marre, a çka po bani. Qysh
23 thu ti, qysh thu kjo, marrëzinë ka bo. 10-15 herë me më pyet
24 për një pyetje, marre ashtë, marre ashtë. Si kjo Gjykatë kurrë
25 në jetë s'kam pa bre. Edhe po përgjigjna në përgjigje teme,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje vijuese Z. Michalczuk Page 90
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 shumë mirë, 30 herë po me vet, çka, çka, çka. S'po di ma çka
2 me fol. Nuk jam normal me fol ma. Duhet me më çu në spital, jo
3 kështu.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit z. Dëshmitar. Nuk
5 kam më pyetje të tjera. Këtu mbyllën edhe pyetjet e mija
6 plotësuese, faleminderit.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit z. Prokuror.

9 Z. Dëshmitar, e kuptoj që këto 3 ditë kanë qenë të gjata
10 dhe shumë të lodhshme. Por pjesëmarrja jote si Dëshmitar është
11 shumë me rëndësi, të gjithëve duhet t'u jepet mundësia me të
12 bo pyetje për këto akuza shumë serioze e të rënda që i bëhen
13 të akuzuarit në këtë gjyq. Të lutem, të lutem na duro edhe
14 pak, edhe shpresoj pastaj ta mbyllim.

15 Zonja Mbrojtëse e Viktimave, keni ndonjë pyetje ju për --
16 a keni ju ndonjë gjë, ndonjë pyetje t'ia bëni dëshmitarit?
17 Edhe nëse po, sa kohë keni nevojë duke pasur parasysh edhe
18 gjendjen e z. Dëshmitar. Po kjo s'duhet t'ju pengojë juve të
19 bëni pyetje, sigurisht.

20 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit Gjykatëse,
21 faleminderit z. Dëshmitar. Unë s'kam asnjë pyetje. Një gjë kam
22 për ta thënë. Sapo e tha edhe z. Dëshmitar, kjo që sapo tha ai
23 konfirmon edhe njëherë nevojën për të mos pasur përsëri këtë
24 gjë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje vijuese te palës tjetër Z. Von Bone Faqe 91
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Dakord po sikur t'i diskutojmë më vonë këto gjëra jo tani?

2 ZNJ. PUES: [Përkthim] Po, faleminderit shumë.

3 Faleminderit, nuk kam më gjë tjetër.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

5 Sekretare e Gjykatës, a mund të na kaloni në seancë publike ju
6 lutem?

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi përsëri në seancë
8 publike.

9 [Seancë e hapur]

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit znj. Sekretare. Shoh nga Avokati i Mbrojtjes.

12 Doni që të bëni pyetje kundër përgjigjes së Dëshmitarit? Nëse
13 po, sa kohë ju duhen?

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, dëshiroj. Por ama në seancë
15 private rreth 7 minuta, në varësi të përgjigjeve që do të marr
16 nga Dëshmitari.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Faleminderit Z. Avokat. Znj. Sekretare, a mund të rikthehemi
19 përsëri në seancë private.

20 SEKRETARJA: Jemi përsëri në seancë private, të nderuar
21 Gjykatës.

22 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit znj. Sekretare. Z. Avokat keni fjalën.

25 Pyetje vijuese te palës tjetër Z. Von Bone:

1 Py. Z. Dëshmitar, faleminderit shumë për durimin edhe
2 për përgjigjet. Kam nja dy pyetje të fundit, kanë [REDAKTUAR]
3 [REDAKTUAR]. E para z. Dëshmitar, përse në asnjë prej
4 deklaratave
5 të tua nuk ja ke përmendur asnjëherë emrin [REDAKTUAR] dhe atë
6 çka [REDAKTUAR] ka bere për ty?

7 Pë. Nuk kam dash me përmend, se s'kam pas nevojë me përmend.
8 Se unë s'mund me i përmend këtu -- ndoshta i shoh një mijë
9 vetë në ditë, kreh me i përmend nuk mujt. Po zotni Prokurori
10 këtu edhe i kam thonë atë ditë, kam bisedu me këtë e i kam
11 thanë, "këtë punë mos e shti në procedurë se nuk po kam qef
12 kurrkujt me ia përmend emrin". Mas shkurti se e kam të parin
13 [REDAKTUAR]. Edhe s'më ka bo ndonjëherë asgja hiç. E për atë
14 shkak. S'kam dash absolut me bo llaf për të hiç.

15 S'jam ardh këtu me kallxu juve për kë di unë, por veç për
16 vete. Për krehjt botën s'jam ardh me ju tregu juve kah çka
17 bojnë, çka bojnë, çka soje. Nuk di ato. Veç e di vetë ça kam
18 bo. Dhe pyetjen ma mirë ma bo drejt veç mua, jo për allk [E
19 pakuptueshme].

20 Py. Pyetja që kam është, përse befas tani në vitin 2021.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
22 Avokat, këtë pyetje sapo ia bëtë, ai u përgjigj shumë qartë.
23 Z. Dëshmitar ju përgjigj shumë qartë për arsyet dhe nuk do
24 t'ua thotë prapë, kështu që ju po përsërisni të njëjtën gjë.
25 Siç e shihni dhe Dëshmitari nuk ndjehet mirë. Siç jua thashë
përpara, mundësinë për me bo pyetje jua japim, por ju lutem

1 mos përsërisni të njëjtat pyetje. Pastaj na takon neve si
2 Gjykatës të vlerësojmë ka vlerë, s'ka vlerë, ka peshë, s'ka
3 peshë përgjigja.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] E kuptoj, por pyetja nuk është,
5 pse s'e ka përmend. Pyetja është, përse ta mbajë jashtë, pse
6 mos me e përmend, pse nuk do që të --.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
8 Avokat, për mua kjo është e njëjta pyetje dhe unë nuk do të
9 lejoj ta bësh këtë pyetje.

10 Z. VON BONE: [Përkthim]

11 Py. A i je përgjigj me vërtetësi pyetjeve të mia?

12 Pë. Po.

13 Py. Pra kur të pyeta, nëse e mësove që emri i këtij personit
14 që nuk do me ja përmend emrin, ishte personi me kapele të
15 kuqe?

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

17 Avokat, a mund, se edhe unë nuk e kuptoj pyetjen, nuk e kuptoj
18 pyetjen. Mund ta thoni pyetjen tamam?

19 Z. VON BONE: [Përkthim]

20 Py. Të pyeta, kur ja mësove, kur e mësove se njeriu me kapele
21 të kuqe që na e tregove ti, ishte personi që të kishte rrah,
22 që ky person ishte personi njeriu emrin e të cilit nuk do me
23 ia përmend. Dhe pyetja që kam, atëherë kur ta bëra këtë
24 pyetje, a je përgjigj me vërtetësi?

25 Pë. Ty s'kam mujt me e kuptu bash mirë se ma ke bo kryt topan

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje vijuese të palës tjetër Z. Von Bone Faqe 94
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 edhe ti. Amon nja 15 herë më ke vet një pyetje të njëjtë, unë
2 s'po di ma me juve qysh me fol kështu. Unë e kam qef me më vet
3 diçka që njeri ashtë q'ishtu. Kështu s'po mujt me kuptu ju çka
4 -- me më pyt 30 herë për një pyetje, s'di çfarë njerëzish jeni
5 kështu. Me kanë i akuzum e s'duhet me ma bo kështu bre, unë
6 jam ardh si dëshmitar. Nuk mujt me fol tashti, pse s'ke fol me
7 atë, me atë. Unë me krejt botën me fol a? E s'kam mujt me ardh
8 me të pyt ty prej atje me kën me fol a, me kën mos fol.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

10 Avokat, për mua edhe kjo pyetje nuk është e qartë. Kështu që,
11 ose bëni një pyetje tjetër ose 7 minutat të kanë mbaru. Nëse
12 keni ndonjë pyetje tjetër ok, po.

13 Z. VON BONE: [Përkthim]

14 Py. Z. Dëshmitar, ti vetë, a e verifikove [REDAKTUAR] e
15 njihte personin e quajtur Cali, a e ke verifikuar apo jo vetë,
16 nëse [REDAKTUAR] e njifte personin Cali?

17 Pë. Po, po. Personal vetë e kam verifiku. Se nuk kam ardh me
18 rrejt këtu. Po.

19 Py. Jo, unë po pyes, a e verifikove dhe nëse po, si e
20 verifikove?

21 Pë. Ç'ashtu qysh kam dit unë e kam verifikue. Qysh me të
22 thonë ty, s'po di qysh.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Dëshmitar, hiqini dëgjueset. Faleminderit.

25 ZNJ. PUES: [Përkthim] Unë kundërshtoj përsëritjen e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03593 (Vazhdim) ~~(Seancë private)~~ (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje vijuese te palës tjetër Z. Von Bone Faqe 95
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 pyetjeve lidhur me verifikimin të cilën e kemi diskutuar.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

3 Mbrojtëse e Viktimave, a mund të më drejtoheni mua? Se mu duk
4 sikur po i drejtoheni.

5 ZNJ. PUES: [Përkthim] Prandaj dhe unë po drejtohesha nga
6 ju ndërkohë që flisja, se mu kujtua menjëherë.

7 Pra, kundërshtoj vazhdimin e pyetjeve të mëtejshme mbi
8 aspektin e verifikimit, sepse po përsëritet. Është mbuluar
9 tashmë gjerësisht më përpara nga Avokati i Mbrojtjes, nuk shoh
10 asgjë të re në këtë pyetje. Duke pas parasysh edhe gjendjen në
11 të cilën ndodhet dëshmitari, besoj duhet theksin duhet ta
12 vendosim që të jemi sa më shkurt tani.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit znj. Mbrojtëse e Viktimave. Z. Avokat, Dëshmitari
15 i është përgjigjur pyetjes. Ka marrë përgjigje, është trajtuar
16 mjaftueshëm.

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Singerisht të nderuar Gjykatës,
18 përgjigje dha po kjo përgjigje -- u përgjigj, "po e ka
19 verifiku". Por pyetja ishte që po.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E po
21 tha, siç dinte, ashtu siç dinte.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Po ashtu tha.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
24 peshën provuese të përgjigjeve mund ta diskutojmë në një
25 moment tjetër. Ai përgjigjen e ka dhënë edhe duhet të

1 mjaftohemi me këtë përgjigje. Mund të vazhdoni me pyetje
2 tjetër, nëse keni pyetje tjetër.

3 Z. VON BONE: [Përkthim]

4 Py. E ke parë ndonjëherë [REDAKTUAR] së bashku me këtë
5 personin Cali që të ishin bashkë?

6 Pë. Kurrë.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk kemi më pyetje të tjera.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit Z. Avokat i Mbrojtjes.

10 Përpara se të vazhdojmë, po shoh orën. Jam informuar
11 gjithashtu edhe se nuk mund të bëjmë dot seancë tjetër të
12 plotë. Të shikojmë se si do të vazhdojmë tani. Por tani dua që
13 të kalojmë në seancë të mbyllur edhe pastaj të shikojmë më
14 tej.

15 Znj. Sekretare, mund të kalojmë në seancë të mbyllur?

16 SEKRETARJA: Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë të
17 mbyllur tani.

18 ~~{Seancë e mbyllur}~~ [Seancë e hapur]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I
20 lutem psikologes apo psikologut t'i afrohet Trupit Gjykses.

21 [Psikologu i viktimës konsultohet met Trupin
22 Gjykses]

23 [Trupi gjykses dhe juristi këshillohen midis
24 tyre]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

1 Sekretare e Gjykatës, të kalojmë në seancë publike përsëri.

2 SEKRETARJA: Të nderuar Gjykatës, jemi rikthyer në seancë
3 publike.

4 [Seancë e hapur]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit znj. Sekretare.

7 Do të bëjmë pushim 5 minuta. Pastaj do të takohemi
8 përsëri këtu.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë.

10 --- Pushimi fillon në orën 15.54

11 --- Seanca rifillon në orën 16.07

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni
13 ju lutem. Ajo që do të bëjmë tani, është që të mos ta
14 vazhdojmë seancën. Do të vazhdojmë nesër në orën 11.30. Edhe
15 për arsye logjistike se s'mund ta mbajmë sallën më shumë se
16 ora 4.30, kështu që kemi vetëm 20 minuta. Edhe po të fillonim,
17 na mbeteshin vetëm 15 minuta dhe kjo nuk na ndihmon që ta
18 mbyllim sot. Por edhe për shkak të dëshmitarit dhe kjo është,
19 këto janë arsyet më të rëndësishme, në mënyrë që t'i japim
20 mundësi e të pushojë. Kjo hëpërhë.

21 I drejtohem Prokurorisë nëse ka ndonjë çështje për të
22 ngritur, në përgjithësi flas.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam
24 asnjë parashtrim hëpërhë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Mbrojtësja e viktimave?

2 ZNJ. PUES: [Përkthim] Asgjë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Avokati?

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Asgjë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
7 mirë atëherë, do të rifillojmë nesër. Falënderoj palët,
8 sigurisht Mbrojtësen e Viktimave dhe Zyrën Administrative për
9 pjesëmarrjen. Dëshiroj të falënderoj përkthyesit, stenografin,
10 teknikët audiovizivë dhe personelin e sigurisë për asistencën
11 e tyre.

12 E mbyllim këtu për sot dhe rifillojmë nesër në ora 11.30.

13 --- Seanca mbyllet në orën 16.09

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25